REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 92/101/104/106/107/109/17
Date/Datum 10.05.2017
PRISHTINË - PRIŠTINA

Republika e Kosovës

Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

AKT PËRCJELLËS

Për:	Menaxherin e prokurimit **Ministria e Shëndetësisë**	Kopje:	Paneli Shqyrtues - OSHP
Prej:	Visar Basha – Ekspert shqyrtues i prokurimit		
Lënda:	Ekspertiza lidhur me Ankesën Nr. **92/17** Ankesën Nr. **101/17** Ankesën Nr. **104/17** Ankesën Nr. **106/17** Ankesën Nr. **107/17** Ankesën Nr. **109/17**		
Datë:	08.05.2017		

Bazuar në nenin 114 të Ligjit Nr. 04/L-042 të Prokurimit Publik të Kosovës ju njoftojmë me raportin e ekspertizës, lidhur me ankesat e OE-ve ankues me nr. 92/17, 101/17, 104/17, 106/17, 107/17 dhe 109/17, lidhur me aktivitetin e prokurimit: **"Ndërtimi i spitalit regjional në Ferizaj"**, me nr. të Prokurimit: 206/16/044/511, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – **Ministria e Shëndetësisë (MSH).**

AK është i thirrur që pas marrjes së raportit të ekspertit shqyrtues lidhur më këtë kërkesë, të veprojë sipas kërkesave të nenit 115 të LPP-së.

Të bashkangjitur gjeni raportin e ekspertit shqyrtues.

Ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues – **MINISTRIA E SHËNDETËSISË.**
- Panelit Shqyrtues – **OSHP.**
- OE ankues – **OPERATORËVE EKONOMIK ANKUES.**

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

		19.04.2017		**19.04.2017**		**08.05.2017**
Nënshkrimi i ekspertit		*Data e autorizimit të eksp.*		*Data e fillimit të ekspertizës*		*Data e dorëzimit të raportit*

N. 105, LPP - Baza ligjore e shqyrtimit

Me datën 31.03.2017, Organi Shqyrtues i Prokurimit ka pranuar ankesën me nr. 92/17 e parashtruar nga OE **"Standard&Alb Architect"**, me seli në Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit: **"Ndërtimi i spitalit regjional në Ferizaj"**, me nr. të Prokurimit: 206/16/044/511, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – **Ministria e Shëndetësisë (MSH).**

Me datën 07.04.2017, Organi Shqyrtues i Prokurimit ka pranuar ankesën me nr. 101/17 e parashtruar nga OE **"Olti Trasing&Beni Com"**, me seli në Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit: **"Ndërtimi i spitalit regjional në Ferizaj"**, me nr. të Prokurimit: 206/16/044/511, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – **Ministria e Shëndetësisë (MSH).**

Me datën 11.04.2017, Organi Shqyrtues i Prokurimit ka pranuar ankesën me nr. 104/17 e parashtruar nga OE **"Pe-Vla-Ku"**, me seli në Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit: **"Ndërtimi i spitalit regjional në Ferizaj"**, me nr. të Prokurimit: 206/16/044/511, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – **Ministria e Shëndetësisë (MSH).**

Me datën 11.04.2017, Organi Shqyrtues i Prokurimit ka pranuar ankesën me nr. 106/17 e parashtruar nga OE **"Alko-Impex"**, me seli në Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit: **"Ndërtimi i spitalit regjional në Ferizaj"**, me nr. të Prokurimit: 206/16/044/511, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – **Ministria e Shëndetësisë (MSH).**

Me datën 11.04.2017, Organi Shqyrtues i Prokurimit ka pranuar ankesën me nr. 107/17 e parashtruar nga OE **"Arbëria Com"**, me seli në Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit: **"Ndërtimi i spitalit regjional në Ferizaj"**, me nr. të Prokurimit: 206/16/044/511, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – **Ministria e Shëndetësisë (MSH).**

Me datën 02.12.2016, Organi Shqyrtues i Prokurimit ka pranuar ankesën me nr. 109/17 e parashtruar nga OE **"Al Trade"**, me seli në Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit: **"Ndërtimi i spitalit regjional në Ferizaj"**, me nr. të Prokurimit: 206/16/044/511, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – **Ministria e Shëndetësisë (MSH).**

Konform nenit 113 te Ligjit Nr. 04/L-042, Eksperti Shqyrtues e ka shqyrtuar dhe analizuar lëndën e (AK) – **Ministrisë së Shëndetësisë (MSH).**

N.111,LPP - Operatorët Ekonomik Ankues:

Pikat e Ankesës nga OE **"Standard&Alb Architect"** - *dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues:*

Neni 6 Faqe 16

Neni 7 Faqe 16

Neni 59 Faqe 51

Neni 65 Faqe 55

Neni 66 Faqe 57

Neni 67 Faqe 58

Neni 68 Faqe 59

Neni 69 Faqe 59

Neni 70 Faqe 62

Neni 71 Faqe 62

Neni 72 Faqe 62

Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet:

Parashtruesi i ankesës është eliminuar nga pjesëmarrja e metejme ne aktivitetin e prokurimit me arsyetimin se tek Kontrata dhe punët e kryera dhe tek deklarata e punëve të kryera, që është cekur në DT , Kërkohet ndërtimi i një objekti Shëndetësor në vlerë prej 500.000.00E me këto punë të parapara :

- Punët ndertimore dhe zejtare
- Punët e instalimeve te elektrikës
- Punët e ngrohjës dhe aklimatizimit
- Sistemi i gazit medicinal
- Punët e ujësjellësit dhe kanalizimit.

Arsyetimi i pikës së parë :

Ne si Operator Ekonomik kemi paraqitur në dosje të tenderit një kontratë e cila është "Renovimi Gjeneral dhe Adaptimi i katit përdhesë në Klinikën interne ne repartin e ri për dializë në QKUK me nr prokurimi 206 11 119551 në shumë prej 695,121.45.00E dhe e cila kontratë sipas kërkesave me dosje të tenderit te shpalluar nga autoriteti i prokurimit pran Ministrisë së Shëndetësi i ka të gjitha këto faza të punëve të kërkuara nga Autoriteti Prokurimit, për punimet e kryera kemi bashkangjitur Procesin e Pranimit Teknik si dhe Referencen për punët e kryera të lëshuar nga autoriteti kontraktues (Ministria e Shëndetësis).

Arsyetimi i pikës së dytë:

Ne si operator ekonomik kemi dorëzuar në ofertë planin dinamik të paraparë me DT të specifikuar detalisht per afatin e përfundimit të punimeve ne 596 ditë pune ne harmoni të plotë me DT dhe në të njetin plan eshte deklaruar qartësisht përfundimi i punimeve per 596 ditë pune sipas planit buxhetor të paraqitur në dosje të tenderit.Bazuar në dokumentacionin e ofruar nga ne të lartëshenuarit mendojm se Autoriteti i Prokurimit ka shkelur ligjet në fuqi, konkretisht nenin 69 dhe 72 të LPP, dhe ligjin e ndërtimit i cili specifikon qartë aktivitetet e ndërtimit dhe renovimit. Ne mendojmë se të gjitha

dokumentat e ofruara në DT, i keni dorëzuar në përputhje me kërkesat dhe me ligjet e ndërtimit.

Arsyetimi i pikës së tretë :

Më dt 20.03.2017 kemi pranuar se Autoriteti Kontraktues gjegjesishtë Ministria e Shëndetësisë e njejta ka shpallur Njoftimin për dhënje të kontratës operatorit ekonomik "FAVOR ING & ASING & ÇLIRIMI "gjë që në bazë të Organit Shqyrtues të Prokurimit : Vendimi i lëshuar NR. 442/16, 443/16, 445/16 ka konstatuar se OE apo konzorciumi në fjalë Kontratën e dorzuar në DT nuk e ka përfunduar objektin dhe i njejti është pa pranim teknik, pasi që në dosje të tenderit tek njoftimi për kontratë shkruan decidivisht se " nuk pranohen projektet e pa përfunduara pa procesverbal të pranimit teknik. Po ashtu edhe ne si OE që kemi bërë kërkesë për qasje në dokumentacion po në njejtin AK kemi vërejuar se OE apo konzorciumi në fjalë që i është dhënë kontrata nuk ka procesverbal të pranimit teknik si dhe Referenc për punët e kryera tek kontrata e Objektit Shëndetësorë Prandaj duke u bazuar në këto dëshmi rrjedhimisht viem në përfundim se OE apo konzorciumi është në tërsi i pa përgjegjshëm pasi që nuk ka ofertuar konform kërkesave të Autoritetit Kontraktues dhe për të njejtin është publikuar Njoftimi për dhënje të Kontratës.Me datë 21.03.2017 kemi pranuar Njoftimin mbi dhënje të kontratës OE FAVOR ING & ASING & ÇLIRIMI, me datë 22.03.2017 kemi bërë ankesë me shkrim (postë) si dhe me Email, kemi kërkuar nga Autoritetin kontraktues gjegjësisht Ministrinë e Shendetësisë përgjigje për ankesën e ushtruar nga ne, por nga ajo datë e deri më sot nuk kemi pranuar asnjë shkresë apo e-mail zyrtar nga AK që me ligj të prokurimit publik është i detyruar në afatet e caktuara të kthej ndonje përgjigjje apo interpretim të tyre. Në vazhdimsi keni të bashkangjitura E-mail e dërguara në Autoritet Kontraktues.

Pikat e Ankesës nga OE **"Olti Trasing&Beni Com"** - *dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues:*

Konsorciumi Olti Trasing&Beni Com Shpk pas analizimit të dosjes së tenderit dhe dokumenteve relevante të Autoritetit Kontraktues për prokurimin: Ndërtimi i Spitalit Regjional në Ferizaj me Nr. të prokurimit: 206/16/044/51 1 Ri - Vlerësim konsideron se Vendimi i Autoritetit Kontraktues për eliminim nga fazat e më tëjme të këtij aktiviteti të prokurimit dhe Raportit i cili do duhej të ishte vendim për refuzimin e Kërkesës për Rishqyrtim është i padrejtë dhe jo ligjor nga se është marrë mbi bazën e shkeljeve të dispozitave ligjore të Ligjit të Prokurimit Publik të Kosovës dhe duke dëmtuar interesin materialo financiar të Konsorciumit në fitimin eventual të kontratës publike në mënyrë të rregullt dhe ligjore.

Shkeljet e dispozitave ligjore nga Ministria e Shëndetësisë janë si në vijim:

- Është shkelur neni 7 i Ligjit të Prokurimit Publik Nr. 04/L. - 042 (Barazia në Trajtim/Jo-Diskriminimi) i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr.04/L-237,ligjin Nr.05/L-068 dhe ligjin Nr.05/L-92
- Është shkelur neni 59 i Ligjit të Prokurimit Publik Nr. 04/L- - 042(ekzaminimi,vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve) i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr.04/I -237.ligjin Nr.05/L-068 dhe ligjin Nr.05/1-92
- Është shkelur neni 41 i Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ për Prokurimin Publik - Është shkelur neni 65 i Ligjit të Prokurimit Publik Nr. 04/L 042(pranushmëria e kandidatëve ose tenderuesve i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr.04/L-237.ligjin Nr.05/L-068 dhe ligjin Nr.05/L-92
- Është shkelur neni 67 i Ligjit të Prokurimit Publik Nr. 04/L- - 042(provat shkresore) i ndryshuar

dhe plotësuar me ligjin Nr.04/L-237.ligjin Nr.05/L-068 dhe ligjin Nr.05/L-92 - Është shkelur neni 69 i Ligjit të Prokurimit Publik Nr. 04/L-042(aftësitë teknike dhe ose profesionale) i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr.04/L-237.ligjin Nr.05/L-068 dhe ligjin Nr.05/L-92

- Është shkelur neni 72 i Ligjit të Prokurimit Publik Nr. 04/L-042(dokumentacioni dhe informacioni shtesë) i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr.04/L-237,ligjin Nr.05/L-068 dhe ligjin Nr.05/L-92
- Është shkelur neni 8.1 dhe 8.1.1 i Rregullave për paraqitjen e kërkesës për rishqytrtim pranë Autoriteteve kontraktuese, dhe parashtrim të ankesave pranë OSHP.

Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet:

Konsorcumi Olti Trasing&Beni Com Shpk do ti prezentoj faktet dhe argumentet në mënyrë të qartë për të demonstruar shkeljet ligjore dhe gabimet e Autoritetit Kontraktues për tenderin: Ndërtimi i Spitalit Regjional në Ferizaj me Nr. të prokurimit: 206/16/044/511. Ri-Vlerésim Ky Konsorcium ka interes materialojuridik në parashtrimin e ankesës pran OSHP nga se është dëmtuar nga Njoftimi i Autoritetit Kontraktues për eliminim nga fazat tjera të këtij Aktiviteti të Prokurimit të ri-vlerësuar dhe Raporti i cili do duhej të ishte vendim për refuzimin e Kërkesës për Rishqyrtim nr.prot: 05-2440 i datës 03.04.2017 i, sepëse ka qenë ofertues i përgjegjshëm dhe nga të përgjegjshmit me çmim më të ulët, dhe i ka plotësuar të gjitha kushtet dhe kërkesat e përcaktuara në dosje të tenderit dhe njoftim të kontratës.

Pikat e Ankesës për shqyrtim - argumentet e potencuara janë në vijim:

Autoriteti Kontraktues - Ministria e Shëndetësisë, ma datën 21.03.2017 ka përcjellë në e-Mailin zyrtarë të Kompanisë Letrën standarde për tenderuesin e eliminuar për aktivitetin e prokurimit të përmendur më lartë sipas tyre se nuk i kemi përmbushë kërkesat nën 9.1 Kërkesat minimale mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale Kërkesa 1. të FTD : Mungojnë sipas tyre kontratat e përfundimit të një ose më shumë objekteve shëndetësore me vlerë të përgjithëshme investive në ndërtim jo më të vogël se 500.000.00 €. Kinse nuk kemi dëshmuar se kemi ndërtuar objekte shëndetësore në vlerë 500,00.00 € siç është kërkuar në njoftimin për kontratë dhe dosje të tenderit.

Konsorciumi Olti Trasing&Beni Com Shpk konsideron se Autoriteti Kontraktues gjatë procesit të ri-vlerësimit të këtij aktivitetit të prokurimit ka shkelur dispozitat e nenit 59 paragrafi 2 i LPP në dëmë tonin e ku është përcaktuar :

Autoriteti kontraktues mundet që me shkrim të kërkojë nga një tenderues që të sigurojë një sqarim me shkrim mbi cilin do nga aspektet e tenderit të tij, në mënyrë që të bëhet ekzaminimi, vlerësimi ose krahasimi i tenderëve. Në rastin konkret nuk është vepëruar sipas patagrafit 2 të këtij neni nga se na është mohuar e drejta e dhënjes së sqarimit rreth qështjeve kontestuese përkatësisht kontratës së ndërtimit të objektit shëndetësorë me vlerë investive jo më të vogël se 500.000.00 €.

Si rrjedhojë e kësaj shkelje e cila është mjaftë esenciale është privimi i mundësisë së garimit, përkatësisht shqyrtimit të ofertës të konsrciumit tonë e cila është e përgjegjëshme dhe i plotëson të gjitha kushtet dhe kriteret e përcaktuara në njoftimin për kontratë dhe dosje të tenderit, në fazat tjera të vlerësimit të këtij aktiviteti të prokurimit e me këte edhe mundësija e fitimit eventual të kontratës publike në mënyrë të drejtë dhe ligjore. Se jan shkelur esencialisht dispozitat e nenit 59 paragrafi 4 të LPP dhe dispozitat e nenit 41.1, 41.3.3.4.1.3.8 dhe 41.5.b të Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ për

Prokurim Publik dhe dispozitat tjera të LPP dhe Rregulave dhe Udhëzuesit Operativ për Prokurim Publik në favor të konsorciumit të rekomanduar për dhënie të kontratës rezulton nga Raporti i vlerësimit të ofertave të Ri-Vlerësimit i datës 10.02.2017 në të cilin është rekomanduar konsorciumi i pa përgjegjshëm për dhënie të kontratës përkundër konstatimit të Panelit të Shqyrtimit të Prokurimit të Organit Shqyrtues të Prokurimit PSH Nr.442/16,443/16 dhe 445/16 i datës 27.01.2017 se ky konsorcium është i pa përgjegjshëm mbi bazën se nuk e plotëson kërkesën e AK rreth kapacitetit teknik ,sepëse i mungon ndërtimi i së paku një objekti shëndetësorë me vlerë investive jo më pak se 500.000.00 euro. Se i mungon një ndërtim i tillë është konstatuar edhe nga përfaqësuesit e konsorciumit në qasje në dokumentacionin zyrtarë ku është vërejtur se konsorciumi i rekomanduar për dhënie të kontratës në projektin Renovation and Refurbishment of Khalifa Bin Zayed Hospital in Vushtrri ka bërë/kryer punë të renovimit dhe mobilimit të tijë e kjo shifet nga referenca e Emirates Link Maltauro L.L.C., Abu Dhabi U.A.E e datës July 25.2016 si dhe Letër Referencë e këtij spitali i nënshkruar nga Hajrullah Saraqi Drejtor Ekzekutiv i spitalit e datës 01.07.2016, Me këte rast janë shkelë rëndë dispozitat e nenit 41.1 të Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ për Prokurimin Publik ku parashifet se kur autoritetet kontraktuese ri-vlersojn procedurën e prokurimit në mënyrë që të korigjojnë vendime të gabueshme dhe kur një ri-vlerësim bëhet si një rezultat i një vendimi të OSHP përfshirë një urdhër për rivlerësim, përkundër asaj që të përmirsojnë gabimin ata e rekomandojnë një konsorcium të pa përgjegjshëm për dhënie të kontratës (Non Sens). Pra rezulton se për Autoritetin Kontraktues: Ministria e Shëndetësisë nuk ekziston organ shtetërorë mbi te i cili konform dispozitave përkatëse në fuqi ligjërisht është i autorizuar të vendos sipas ankesave të operatorëve ekonomit në lëmin e prokurimit publik dhe se vendimet e tyre janë të obliguara në zbatim. Më pastaj është vepëruar në kundërshtim të nenit 41.3.3 dhe 5 të Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ për Prokurimin Publik ku janë paraparë parimet kryesore të vlerësimit sipas LPP, ku në pikën tre të këtij neni është paraparë se tenderët duhet të plotësojnë substancialisht kushtet obligative teknike të specifikuara e që ky konsorcium nuk i plotëson nga se i mungon kontrata për ndërtim të objektit shëndetësorë në vlerë investive jo më pak se 500.000.00 euro dhe deklarata e konsorciumit me të cilën garantojn se është i përgatitur që ta kryej ndërtimin e objektit në tërësi për një afat kohorë maksimumi 600 ditë pune-kërkesa 4 nën 9.1 të FTID se , Në pikën 8 të këtij neni është paraparë se dhënia e kontratës do të bëhet në pajtim rigoroz me vlerësimin e kryer sipas shtatë parimeve të cekura më lartë që asesi nuk është vepëruar nga autoriteti kontraktues, ndërsa në dispozitat e nenit 41.5.b të rregullave dhe Udhëzuesit është paraparë se tenderi konsiderohet të jetë i përgjegjshëm (41.5) kur nën pikën b është në pajtushmëri me termet teknike me përshkrimin, kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në dosje të tenderit gjë që nuk është vepëruar nga komisioni i ri-vlerësimit. Vlenë të thekësohet se gjatë qasjes në dokumentacion është vërejtur Veqim i mendimeve të anëtarëve të komisionit të ri-vlerësimit ku ka edhe favorizime të operatorëve ekonomik të caktuar, andaj shtrohet pyetja se komisioni ka qenë kompatibil me natyrën e këtij aktiviteti të prokurimit dhe a ka vepëruar i paanshëm dhe pa ndikime ashtu siq parashifet në dispozitat përkatëse të LPP. Në faqen 12 të Raportit të rivlerësimit figurojnë tre (3) OE të përgjegjshëm dhe këta Fayor ing&As lng& Çlirimi, Arbëria Com dhe Standard&Alb Architect, i dyti dhe i treti konsiderohen si të pasuksesshëm, ndërsa në faqen 13 të raportit të vlerësimit te Deklarata janë numëruar 18 operatorë ekonomik të pa përgjegjshëm në mesin e tyre edhe konsorciumi | Standarda&Alb Architect, prandaj shtrohet pyetja si është e mundur që njëkohësisht konsorciumi i apostrofuar të jetë i përgjegjshëm dhe i pa përgjegjshëm situat për dyshime të bazuara se këtu diq nuk është në rregull aq më parë kur të kihet parasysh se për papërgjegjshmërin e tijë qëndron konstatimi i panelit shqyrtues të OSHP.Në qasje në

dokumentacion zyrtarë kemi vërejtur se këtij konsorciumi Standarda:Alb Architect i mungon kontrata e ndërtimit të institucioneve shëndetësore dhe deklarata lidhur me afatin prej 600 ditëve për kryerjen e punëve. Prandaj shtrohet pyetja mos vallë komisioni i rivlerësimit të ofertave ka pas frikë se nuk do ketë mjaftë OE të përgjegjshëm dhe se vetëm ata i dijnë arsyerat e futjes së këtij konsorciumu në OE të përgjegjshëm

Argument 1: Neni59 i LPP , i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr.04/L-237,ligjin Nr.05/L-068 dhe ligjin Nr.05/L-92 dhe neni 4.1.1,41.3.3,41.3.8 dhe 41.5.b i Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ për Prokurim Publik si dhe Raporti i Ri-vlerësimit të ofertave.

Konsorciumi Olti Trasing&Beni Com Shpk konsideron shkelje të radhës gjatë procesit të ri-vlerësimit të ofertave dispozitat e nenit 72 të LPP i riformuluar me nenin 47 të Ligjit Nr.05/L-68, Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr.04/L-042 për prokurimin publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr.04/L-237 ku në paragrafin 1 parashifet se kur informacioni apo dokumentacioni që duhet të dorëzohet është ose duket të jetë jo i plotë ose i gabuar, ose kur mungojnë dokumentet specifike AK mund të kërkojnë nga OE që të dorëzojnë, plotësojnë sqarojnë apo kompletojnë informacionin apo dokumentacionin e duhur brenda një afati të caktuar kohorë.

Në rastin konkret nuk është vepëruar konform kësaj dispozite me vet faktin e mohimit të së drejtës të dhënijes së sqarimeve rreth qështjes së kontratave të përfundimit të një ose më shumë objekteve shëndetësore me vlerë të përgjithëshme investive në ndërtim jo më të vogël se 500,000.00 € pasi që kontratat e parashtruara për ndërtim të objekteve të kërkuara i plotësojnë të gjitha kushtet e kontratave të parapara dhe të kërkuara nga AK në njoftimin për kontratë dhe dosje të tenderit. Qdo paqartësi lidhur me kontratat e kërkuara është dashur të sqarohet me Konsorciumin tonë, prandaj nga ana e konsorciumit konsiderohet shkelje e rëndë nga Autoriteti Kontraktues aq më parë kur të kihet parasysh se një gjë e tillë i është mundësuar operatorëve tjerë ekonomik pjesëmarrës në këte aktivitet të prokurimit.

Argument 2: Neni 72 i LPP , i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr.04/L-237,ligjin Nr.05/L-068 dhe ligjin Nr.05/L-92

Pastaj sipas mendimit të konsorciumit tone është shkelur neni 65 i Ligjit të Prokurimit Publik Nr. 04/L-042(pranushmëria e kandidatëve ose tenderuesve i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr.04/L-237,ligjin Nr.05/L-068 dhe ligjin Nr.05/L-92 Në paragrafin 4.6 të këtij neni është parapa se operatori ekonomik nuk ka të derjtë që të marrë pjesë në një aktivitet të prokurimit nëse aktualisht është lëndë e një vendimi gjygjësorë ose administrativ gjë që në rastin konkret anëtari i konsociumit i rekomanduar në ri-vlerësim për dhënie të kontratës Çlirimi është në një situat të tillë e kjo është konstatuar nga qasja në dokumentacionin zyrtarë ku nga Certifikata e Gjykatës Themelore në Prishtinë GJ.A. Nr.2689/16 e datës 07.06.2016 rezulton se NPN Çlirimi-Korishë-Prizeren me nr.te regjistrimit të biznesit:80123329 ka Lëndë në procedurë kontestimore: Ek. Nr.518/13, Ek.Nr.149/14 kështu që komisioni i rivlerësimit të ofertave është dashur ta eliminoj si të pa përgjegjshëm menjëherë e jo ta rekomandoj këte konsorcium pë dhënie të kontratës

Argument 3: Neni 65 i LPR , i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr.04/L-237,ligjin Nr.05/L-068 dhe ligji Nr.05/L-92 dhe çertifikata e Gjykatës Themelore në Prishtinë GJ.A.Nr.2689/16 e datës 07.06.2016

Më pastaj Autoriteti Kontraktues sipas mendimit tonë gjatë procedurës së ri-vlerësimit ka bërë shkelje të nenit 67 të LPP ku në paragrafin 2 është përcaktuar: Autoriteti Kontraktues e s'kualifikon çdo kandidat ose tenderues që nuk paraqet: (i) certifikatat ose dëshmitë e nevojshme për të treguar ose konfirmuar se ai nuk shkualifikohet sipas nenit 65 49 të këtij ligji, (ii) certifikatë, dokument ose ndonjë provë tjetër të mjaftueshme që në mënyrë të arsyeshme kërkohet nga autoriteti kontraktues sipas nenit 66 të këtij ligji me qëllim të verifikimit të përshtatshmërisë profesionale të kandidatit ose tenderuesit, ose (iii) prova të mjaftueshme, sipas nenit 68 dhe 69 të këtij ligji që në mënyrë të arsyeshme tregojnë së kandidati ose tenderuesi i plotëson kushtet minimale financiare, teknike dhe profesionale të përcaktuara në dosjen e tenderit ose në njoftimin e kontratës. Në rastin konkret Autoriteti Kontraktues ka vepëruar në kundërshtim me këte dispozitë ligjore nga se ne si konsorcium i kemi plotësuar të gjitha kushtet e përcaktuara sipas këtij neni dhe atyre të përcaktuara në dosje të tenderit dhe njoftimit për kontratë, ndërsa konsorciumi i rekomanduar për dhënie të kontratës nuk i ka plotësuar të gjitha kriteret dhe kërkesat e Autoritetit Kontraktues të përcaktuara në njoftimin për kontratë dhe dosje të tenderit - kërkesat nga neni 65 dhe 69 të LPP. mirëpo prap është rekomanduar për dhënie të kontratës.

Argument 4: Neni 67 i LPIP , i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr.04/L-237,ligjin Nr.05/L-068 dhe ligjin Nr.05/L-92

Ky konsorcium konsideron se është bëre shkelje e nenit 69 të LPP ku në paragrafin 6 është paraparë. Në procedurat që shpijnë në dhënien e kontratës publike në të cilën përfshihet realizimi i projekteve të punëve ose realizimi i aktiviteteve ndërtimore, autoriteti kontraktues mund të kërkojë nga operatorët ekonomik të sigurojnë të dhënat me të cilat dëshmohet aftësia e tyre teknike dhe profesionale për kryerjen e projekteve të tilla ose realizimin e aktiviteteve të tilla, në veçanti, autoriteti kontraktues mund të kërkojë të dhëna përkitazi me: 6.2.listën me të cilën specifikohen të gjitha projektet e punëve dhe aktivitetet ndërtimore të realizuara në periudhën e shkuar tre vjeqare, të përcjella me certifikata për kryerjen dhe ose përfundim të knaqshëm të projekteve më të rëndësishme të punëve dhe ose aktiviteteve ndërtimore, certifikatat përcaktojnë vlerën, datën dhe vendëndodhjen e projekteve të punëve dhe ose aktiviteteve ndërtimore dhe specifikojn nëse janë kryer dhe ose përmbushur në përputhje me rregullat tregtare dhë janë përfunduar siç duhet, sa here që është e mundur, autoriteti kontraktues mund të obligohet që të dakordohet me autoritetin publik kompetent në Kosovë ose në vendin tjetër që kopjet e certifikatave përkatëse tia paraqes drejtpërdrejtë autoritetit kontraktues.

Edhe kjo kërkesë në tërësi është përmbushur nga konsorciumi ynë në verzionin si të parashtrimit të kontratave të kërkuara, përkatësisht parashtrimit të kontratës për ndërtimin e objektit shëndetësorë e lidhur në mes Konsorciumit NNP Euroing& Olti Trasing Shpk me Fondacionin Caritas Luxemburg-FCI-Representation Office Kosovo datë 20 Nëntor 2014, andaj mbi këte bazë konsorciumi i jonë nuk është dashur të eliminohet nga fazat e mëtejme të vlerësimit të këtij aktiviteti të prokurimit. Se është shkelur kjo dispozitë ligjore në dëmë të konsorciumit tonë më së miri argumentohet nga fakti i pranimit si të përgjegjshëm të konsorciumit të rekompanduar për dhënie të kontratës nga Autoriteti Kontraktues përkundër asaj se i njajti është konstatuar i pa përgjegjshëm nga OSHP-ja, Vendimi PSH Nr.442/16,443/16.445/16 i datës 27.01.2017 Në qasje në dokumentacion zyrtarë kemi vërejtur se ofertës së Al Trade i mungon i realizimi i projektit të një objketi shëndetësorë në shumë investive jo më

të vogël se 500.000.00 euro gjatë viteve 2013.2014.2015 pranohen edhe të vitit 2016, pra i njejti nuk ka ofruar prova se ka ndërtuar dhe përfunduar punë të kërkuara në shumën e thekësuar, sepëse nga qasja në dokumente zyrtare rezulton se objekti në Skenderaj pjesërisht është i kryer qka rezulton edhe nga kërkesa e OE për pranim të pjesshëm.Poashtu kemi vërejtë se nuk ka asnjë kontratë për ndërtim të objektit shëndetësorë në vlerën e kërkuar përfshirë komunën e Prishtinës/ Pra këtu pajtohemi me konstatimin e AK se ky OE është i papërgjegjshëm mbi këte bazë.

Argument 5: Neni 69 i LPP , i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr.04/L-237,ligjin Nr.05/L-068 dhe ligjin Nr.05/L-92, dhe kontrata e datës 20 Nëntor 2014 e lidhur në mes Konsorciumit NNP Euroing& Olti Trasing Shpk me Fondacionin Caritas Luxemburg-RCI-Representation Offoce Kosovo me titull: Constrction of Maim Family Medicine Center - MFMCbuilding in Kaçanik me nr.prokurimi: FC-14-005-HEA-KAC me referene dhe proces të pranimit të punëve dhe Vendimi i Panelit Shqyrtues i Prokurimit të OSHIP i datës27.01.2017

Më pastaj konsorciumi i jonë konsideron se është bërë shkelje e nenit 7 të LPP ku në paragrafin 1 është paraparë: Se të gjitha autoritetet kontraktuese, do ti trajtojn operatorët ekonomik në mënyrë të barabart dhe jo-diskriminuese dhe do të veprojnë në mënyrë transparente. Se nuk është vepëruar konform kësaj dispozite ligjore argumentohet me faktin e parashtrimit të kontratës së thekësuar në argument nën 5 të cilën autoriteti kontraktues e ka pasur në dokumentacionin e dosjes së tenderit, andaj nga ky fakt dhe si rrjedhoj e sajë domosdoshmërisht vjen në shprehje trajtimi jo i barabart i konsorciumit tonë në krahasim me operatorët tjerë ekonomik të cilën e konsiderijmë shkelje esenciale dhe mohim i së drejtës së kualifikimit në fazat tjera të vlerësimit të këtij aktiviteti të prokurimit aq më parë kur të kihet parasysh se të gjithë operatorëve tjerë ekonomik i është dhënë mundësia për sqarime shtesë ashtu siq parashifet në nenin 72 të LPP

Argument 6: Neni 7 i LPP , i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr.04/L-237,ligjin Nr.05/L-068 dhe ligjin Nr.05/L-92 dhe

së fundi konsorciumi i jonë konsideron shkelje tejet esenciale nga autoriteti kontraktues: Ministria e Shëndetësisë dispozitat e nenit 8.1 dhe 8.1.1 të Rregullave për paraqitje të kërkesës për rishqyrtim pranë Autoriteteteve Kontraktuese, parashtrim të ankesave pranë OSHP ku në paragrafin 1 të nenit 8 taksativisht është përcaktuar se Autoriteti Kontraktues, respektivisht Zyrtari përgjegjës i Prokurimit mundë me anë të një vendimi: pika 1 e paragrafit 1 të nenit 8: citojm të refuzoj kërkesën e propozuar për shqyrtim si të pabazë. Se është bërë shkelje e dispozitave të thekësuara më së miri shifet nga Raporti i shqyrtimit të ankesës/kërkesës për rishqyrtim të konsorciumit nga Autoriteti Kontraktues ku në mënyrë kronologjike është dhënë përshkrimi i punës së komisionit të vlerësimit gjatë shqyrtimit të sajë e i cili Raport nuk është i nënshkruar nga të gjithë anëtarët e komisionit dhe i cili më së paku i gjason Vendimit nga se nuk e ka formën dhe elementet e vendimit, sepëse nuk ka hyrje, dispozitiv, arsyetim dhe udhëxim për mjetin ankimorë. Përkundër të gjithë kësaj më esencialja është se i njajti nuk është marrë nga Zyrtari përgjegjës i Prokurimit të Autoritetit Kontraktues ashtu siq parashifet në dispozitat e thekësuara e që konsiderohet shkelje thelbësore e dispozitave të përmendura.

Argument 7 neni 8.1 dhe 8.1.1 i Rregullave për paraqitjen e kërkesës për rishqytrtim pranë Autoriteteve kontraktuese, dhe parashtrim të ankesave pranë OSHP

Pikat e Ankesës nga OE **"Pe-Vla-Ku"** - *dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues:104/17*
Neni 7 i LPP-se - Barazia ne Trajtim/ Jo Diskriminim

Neni 56 i LPP-se - Dispozitat e Përgjithshme mbi Perzgjedhjen e Pjesemarrseve dhe dhenien e kontratës

Neni 59 i LPP-se Ezaminimin, vleresimin dhe krahasimin e tëndereve

Neni 60 i LPP-se - Kritëret per dhenien e kontratës

Neni 72 i LPP-se - Dokumentacioni shtëse

Neni 105 i LPP-se - Kompetencat e OSHP-së, Pika 2.8 dhe 2.10

Neni 115 i LPP-se - Vendimi i autoritetit kontraktues, Paragrafi 6

Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet:

Gjatë procedurës se aktivitëtit të prokurimit me Titull: Ndertimi i Spitalit Regjional ne Ferizaj, me numer prokurimi: 206/16/044/511 - Autoritëti Kontraktues ka bërë shkelje të Ligjit për Prokurim Publik Ligjit Nr. 04/L-042 per Prokurimin Publik të Republikes se Kosoves i ndryshuar dhe i plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, përkatësisht neneve të lartëcekura.

Kompania jonë me datën 21/03/2017 ka pranuar një e-mail permes se cilit e-mail ne njoftohemi se jemi eliminuar si tënderues i passukseshem ne aktivitëtine prokurimit me Titull: Ndertimi i Spitalit Regjional ne Ferizaj, me numer prokurimi 206/16/044/511.

Duke u bazuar ne arsyetimet të cilat na keni dhene, të cilat arsye tregojne se pse ne jemi shpallur tënderues i pasukseshem na bene të kuptojm qe Autoritëti Kontraktues ka bere shkelje të Ligjit të Prokurimit Publik të lartë cekur.

Arsyet e diskualifikimit janë këto:

Inxhi. Mekanik për transport dhe bujqësi Avni Sokoli nuk është i profilit adekuat siç është kërkuar inxhi i Makinerisë, dhe nuk ka referenca te punës profesionale siç është kërkuar për min. 5 vite, nuk kemi kërkuar inxhinier mekanik për transpori dhe bujqësi gjë qe dëshmon edhe dokumentacioni përcjellës: Diploma universitare, CV, Referenca.

- Pas kërkesës për informate sqaruese OE ka vërtetuar profilin e diplomës te inxhinierit Avni Sokoli qe është Mekanik për transport dhe bujqësi.
- Inxhinieri Avni Sokoli nuk ka dëshmi qe po i njëjti ka kryer pune ne lëmin përkatëse qe është kërkuar ne dosje te tenderit.

Çështje tjetër është edhe qe inxhinier Avni Sokoli nuk I përputhet mbiemri ne shumicën e dokumenteve te ofruara nga OE, siç është ne diplomën e universitare mbiemri është Sokoli ndërsa ne Certifikatën e notave është Sokolaj, ne reference nga bashkia e Kavajë është Sokoli ndërsa ne dokumentin e administratës tatimore është Sokolaj. Kjo është përsëritur edhe ne dokumente tjera ku ne si komision kemi vërejtje ne deklarim te rrejshëm te dokumenteve sipas LPP neni 130.

Sa i perket arsyes të eliminimit lidhur me inxh. Mekanik per transport dhe bujqesi Avni Sokoli nuk eshtë i profilit adekuat siq eshtë kerkuar inxh. i Makinerisë, dhe nuk ka referenca të punes profesionale siç eshtë kerkuar per min. 5 vitë, nuk kemi kerkuar inxhinier mekanik per transport dhe bujqesi.

Ne ju konfirmojme se kjo arsye e eliminimit eshtë e pa qëndrueshme sepse inxhinieri ne fjale posedon

referencen mbi pervojen 5vjeqare dhe e njejta reference eshtë ne ofertën tone dhe ne dosjen e tënderit kurse pretendimi i AK se inxhinieri ne fjale nuk eshtë i profilit adekuat, ju perkujtome.se i njejti ka titullin e inxhinerit të deges mekanike gje qe eshtë primare ndersa drejtimi per transport dhe bujqesi gje qe eshtë sekondare, pra ne baze të diplomes ai e gezon titullin inxhinier i makinerise. Ne kemi sjelle tek AK deshmi per vlefshmerine e diplomes se inxhinierit ne fjale ja edhe licencen e ministrise se puneve publike dhe të transportit ku ne baze të kesaje licence rezulton se z. Avni Sokoli eshtë i licencuar per të gjitha katëgoritë e puneve të ndertimit si dhe per pune speciale të ndertimit e të cilat perfshihen edhe ne ketë aktivitet të Prokurimit Publik.

Shoqeria PE-VLA-KU sh.p.k ju ben me dije se inxhinieri mekanik Avni Avdyl Sokoli eshtë diplomuar ne Fakultetin e inxhinierise të Universitëtit të Tiranes dega / Mekanike ne vitin 1977,sot Universiteti Politëknik i Tiranes. Ne baze të vertëtimit qe eshtë leshuar nga Universiteti Politeknik i Tiranes, i cili eshtë derguar te AK, del qartë se ne periudhen kur Avni Avdyl Sokoli eshtë diplomuar ne profilin Transport e Buqesi, ka qene i vetmi profil i inxhinierise Mekanike ne atë periudhe. Marre ne konsideratë kurrikulat e periudhes qe Avni Sokoli ka studiuar, ai i kryen të gjitha funksionet e nje inxhineri mekanik. Titulli inxhinier Mekanik ne Republiken e Shqiperise eshtë i barazvleshem me titullin inxhiner i makinerise ne Republiken e Kosoves.

Nga të cekurat me lartë rezulton se Autoritëti Kontraktues perkitazi me ketë qeshtje ka bere shkelje të Nenit 7 të LPP-se -Trajtim jo të barabartë të OE pjesmarres. Gjithashtu kjo qeshtje eshte argumentuar ne seancen degjimore prane OSHP ku kemi ofruar deshmi nga Universiteti i Tiranes dhe me kete rast OSHP-ja ka marr vendim dhe ka mbeshtetur vendimin ankimor perkitazi me nenin 72 te LPP-se , se inxhinieri jone ne fjal i plotesor kriteret per stafin teknik professional qe jane kerkuar ne dosje te tenderit.

Kurse sa i perket asaj se ju keni thene se ne shume dokumente nuk perputhet Mbiemri inxh. Avni Sokoli diku eshte Sokoli e diku eshte Sokolaj. Ne ju konfirmojme se inxhinieri ne fjale eshte Avni Avdyl Sokoli i lindur ne Tropoje me 10.05.1952.

Kontrata i eshte bere duke u bazuar ne leternjoftimin e tij qe eshte Avni Sololaj, si dhe lista e puntoreve e cila eshte marr nga Administrata Tatimore-Shqiperi eshte bazuar ne te dhenat e leternjoftimit, kurse ne dokumentet e institucioneve Universitare eshte Avni Sokoli. Ne e konfirmojme se behet fjale per te njejtin inxhinier sepse ne kontrate eshte e cekur data e lindjes, numri i leternjoftimit dhe numri i diplomes. Keto jane gabime teknike-administrative te cilat i ka dokumentuar edhe noterja Xhevahire Brahaj permes deklarates noteriale te dt.06.04.2017 permes se ciles deklarate konfirmohet se AVNI/avdyl/ Sokolaj apo AVNI/Avdyl/Sokoli jane po i njejti person, gje qe vertetohet permes nr.personal te ID-kartes, por ne rastin konkret kemi te bejme me permutacion te njerezve te administrates.:

Prove nr.1 : Deklarata noteriale qe i bashkangjitet ankeses.

Pra ne baze te deklates noteriale verehet qarte se arsyea e eleminimit perkitazi me kete qeshtje nuk eshte e bazuar dhe se autoriteti kontraktues ka mundur fare leht ta vertetoj duke iu referuar nenit 72 te LPP-se.Sipas nevojes ne jemi te gatshem qe para panelit te OSHP-se te parashtrojme edhe dokumente plotesuesi siq eshte lista e stafit per kontributet personale ku deshmohet pretendimiljone.

Sa i perket arsyes se dytete eleminimit tone se gjoja z.Avni Sokoli ne cilesite ing.te dipl. nuk posedon referenca per kryerjen e puneve ne 5 vitet e fundit-ne ju konfirmojme se kjo arsye e eleminimit nuk

qendron per faktin se z.Avni Sokoli ka me teper se pese vite pervoje pune dhe per kete ne ankeses sone ia bashkangjesim referencen e dt. 07.04.2017 leshuar nga nga bashkia e Kavajes permes se ciles konfirmohet se z.Avni Sokoli ka me teper se 5 vite pervoje te punes.Pra autoriteti kontraktues edhe lidhur me kete qeshtje nuk ka respektuar nenin 72 te LPP-se dhe nenin 39 te UOPP-Se.

Prove nr.2 ; Parashtresa e Bashkise se Kavajes.

Sa i perket OE. i rekomanduar per shperblim me kontrate, ne pretendojmë se ky OE është i papërgjegjshëm për arsye se nuk e ka plotësuar kriterin ku kërkohet të ketë perfunduar nje apo me shume objekte shëndetësore ne ndertim e me vlere jo me të vogel se 500,00.00euro.Si konsorcium kane prezantuar nje reference per objektin renovim nga spitali " Sheik Zajed" ne Vushtrri dhe punëkryes"Favoring" si antar.

Paneli shqyrtues duke u bazuar ne të gjitha deshmitë, argumentët ne lidhje me ketë aktivitët të prokurimit, raportin e ekspertit shqyrtues, pergjigjet e paleve ne procedure, deshmitë e prezantuara dhe diskutimet e bera ne Séancen degjimore, konstatoi se konzorciumi "Favoring & ASing & Clirimi" nuk e ka plotësuar kerkesen e autoritetit kontraktues perkitazi me kapacitetin teknik dhe professional, ku eshtë kerkuar qe "operatori ekonomik duhet të ofroje deshmi se ka perfunduar me sukses projektë ne lemin e ndertimtarise gjatë tri vitëve të fundit marr se bashku (2013,2014,2015pranohen edhe të 2016) ne vlere prej 5milion euro. Kerkohet të ketë perfunduar se paku nje objekt shendetësor me vlere investive ne ndertim jo me të vogel se 500,000.00euro. Nuk pranohen projektët e pa perfunduara pa procesverbal të pranimit tëknik"

Gjithashtu paneli shqyrtues konstaton se autoriteti kontraktues me dt.16.01.2017 ka kerkuar shqarime shtese nga Spitali Sheik Zayed-Vushtrri, se a eshtë bere pranimi teknik i projektit gjegjesisht pranim dorezimi i puneve ne renovimin e spitalit, ndersa me të njejtën datë kane marr pergjigjie nga Drejtoriz.Mujë Ferati ku sqarohet se pranimi teknik i puneve të kryera ne renovimin e spitalit të Vushtrrise nuk eshtë bere.

Prandaj referenca e ofruar nga antari i konsorciumit "Favor ing" per projektin "Renovation and Refurbishment of Khalifa Bin Zayed Hospital in Vushtrri" nuk mund të mirret parasysh, pasi qe ne dosje të tenderit dhe tek njoftimi per kontratë shkruan decidivisht "Nuk pranohen projektet e pa perfunduara pa procesverbal të pranimit teknik". Ndersa ne rastin konkret, shefi i prokurimit prane autoritetit kontraktues permes parashtresave ka njoftuar edhe autoritetin kontraktues edhe OSHP-en se pranimi teknik i puneve nuk eshte bere prane ketij spitali e as reference per pune te kryera nuk ka leshuar.Konform dispozitave te LPP-se, veten autoritetet kontraktuese jane kompetente per pranim teknik dhe leshim te referencave e jo edhe donatoret eventual.

Vlene per tu theksuar se edhe sikur te merrej per baze referenca e prezentuar nga Operatori ekonomik i rekomanduar per shperblim me kontrate, megjithate as referenca ne fjale nuk do te ishte valide, per faktin se e njejta nuk perkon me natyren e ketij aktiviteti te prokurimit, sepse ne rastin konkret eshte kerkuar reference per pune ndertimore(ndertim i spitalit nga themeli), ndersa OE.i rekomanduar per kontrate ka ofruar vetem reference per renovim te spitalit dhe ate ne cilesite" nenkontraktorit", gje qe bie ndesh me natyren e ketij aktiviteti te prokurimi.Per me teper vet paneli shqyrtues I OSHP-se me vendimin e vet PSH. nr.442/16 te dt.27.01.2017 e ka konfirmuar pretendimin tone perkitazi me qeshtjen e references ne fjale dhe se vendimi I apostrofuar i OSHP-es e ka legjitimuar pretendimin tone lidhur me pa pergjegjeshmerine e OE.te rekomanduar per shperblim me kontrate dhe se

"pergjegjeshmeria" e ketij operatori per ne eshte qeshtje e gjykuar/res judicata/ nga ana e "gjykates se tendereve" dhe se autoriteti kontraktues ka qene i obliguar ta zbatoje ne menyre strikte vendimin e panelit shqyrtues, ne te kunderten vendimin e panelit shqyrtues, autoriteti kontraktues dhe OE.i rekomanduar ka mundur ta atakoje vetem ne procedure gjyqesore, e asesi ta kontestoje ne kete forme, kur dihet se conform dispozitave te LPP-se, OSHP-ja eshte i vetmi organ vendimmarres si organ i shkalles se dyte.Pra vendimi i autoritetit kontraktues eshte arbitrar/1 jashte ligjshem/ dhe ne kundershtm me vendimin e gjykates se tendereve

Prandaj duke u bazuar ne keto deshmi rrjedhimisht vime ne perfundim se ky operator ekonomik eshtë i papergjegjshem pasi qe nuk ka ofertuar konform kerkesave të autoritetit kontraktues perkitazi me kapacitetin teknik/professional.

Ne si pale me interes juridiko-material conform nenit 111.par.1 pika 1-5, lidhur me nenin 4.1. 26 te LPP-se gjithashtu ju konfirmojme se pas qasjes se dokumentacionit tenderik te ketij aktiviteti te prokurimit kemi hasur se edhe OE."Standard & Alb Architekt". I ranguar si oferte e katert ju konfiromje se i njejti nuk eshte i pergjegjeshem dhe se te njejtit i mungon : nje kontrate e perfunduar ne lemin e shendetesis me vlere minimale prej 500,000.00 euro dhe i mungon deklarata qe deshmon se perfundimet do te perfundojne ne afat kohor maksimum 600 dite pune.Pra edhe ne kete rast autoriteti kontraktues nuk ka respektuar nenin 59, 60 dhe 61 te LPP.

Nga të cekurat me lartë konkludohet se AK ne rastin konkret ka bere shkelje të Nenit 1, 6, 7, 59, 65, 72 të LPP-se.

Te gjitha keto konstatime dhe prova te lartecekura vertetojne se Autoriteti Kontraktues ne rastin konkret ne mënyrë flagrante ka bërë shkelje esenciale te dispozitave te lartecekura te LPP-Se.

Nga te cekurat me lart i propozojme Organit Shqyrtues te Prokurimit qe ankesen tone ta aprovoj si te bazuar dhe lëndën ta kthej në rivleresim.

Pikat e Ankesës nga OE **"Alko-Impex"** - *dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues:106/17*
Neni 1 Qëllimi

Neni 6 Ekonomiciteti dhe Efikasiteti

Neni 7 Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi

Neni 56 Dispozitat e Përgjithshme mbi Përzgjedhjen e Pjesëmarrësve dhe Dhënien e Kontratave

Neni59 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve

Neni 60 Kriteret për Dhënien e Kontratës

Neni 71 Grupet e Operatorëve Ekonomik dhe Operatorët e Huaj Ekonomik

Neni 72 Dokumentacioni dhe informacioni shtesë

Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet:

Me date 21.03.2017 kemi pranuar nga AK-ja, letren standarde per tenderuesin e eleminuar permes te ciles jemi njoftuar per 2(dy) arsyet e pretenduara te eleminimit. Gjithashtu jemi njoftuar se kontrata i eshte dhene grupit te OE-ve "Favor ing & As lng & Clirimi" edhe pse kjo kompani ka ofruar nje qmim

prej 8.916.285,44e ndersa cmimi i ofertes tone ka qene 8.740.144,18é, pra AK-ja ne kundershtim me qëllimin dhe me te giitha procedurat e LPP-se po tenton qe te demtoj buxhetin e Republikes se Kosoves ne vlere prei 200.000,00€.

Me poshte ju ofrojme nje sqarim detal per t'ju faktuar se arsyet e pretenduara te AK-es per eleminimin tone nuk qendrojne.

Arsyeja e 1-re e pretenduar nga AK-ja:

Nuk e keni plotësuar si duhet listën e Çmimeve - pjesën I Paramasa dhe Parallogaria, konkretisht nuk ka ofruar Çmim ne këto pozicione: 1.1 - poz.27, 1.2 - poz.9; 1.7 - poz.10, 2.2 - poz.12 ; 2.3 - poz.10, 2.4 - poz.4 ; 2.5 - poz.12 ; 2.6 - poz.15; 3.1 - poz. I fundit.

Sqarim:

Ne si grup i OE-ve konsiderojme se kjo arsye e eleminimit nuk qendron dhe nuk eshte e vertete qe ne nuk kemi plotesuar çmimet e ketyre pozicioneve por ne nuk kemi bere llogaritjen e perqindjeve te kerkuara ne keto pozicione prandaj deklarojmë me përgjegjësi të plotë juridike dhe penale se në këto pozicione nuk është kërkuar te plotësohet ndonje qmim i ndonje artikulli/materili/pune ose gjdo gje tjeter qe kerkohet çmim nga ne si OE, por vetëm është dashur që të bëhet llogaritja e perqindjes së kërkuar në secilin nga keto pozicione, e kjo llogaritje ka qënë shumë e lehtë të bëhet edhe nga AK gjatë fazës se vlerësimit. Meqenese AK e ka pasur te veshtire te bej kete llogaritje me poshte po ju ofrojme te gjitha keto llogaritje matematikore te ketyre pozicioneve te cilat janë :

1.1 poz.27

27	**Material tjeter lidhes 5% nga totali I kesaj pike**	5% 0.04	
		Gjithsejt poz 1.1	67.004,00 €.

Ne kete pozicion eshte kerkuar qe çmimi njësi te jetë 5% nga totali i të gjitha pozicioneve të mësipërme. Prandaj meqenese totali i te gjitha pozicioneve te mesiperme eshte 67.004,00 €, eshte shume e lehte qe ky Çmim te nxirret. Pra 5% e 6Z.004,00 = 3.350.20. Dmth Çmimi njësi i poz1.1.2.Z është 3.350.20 €, ndersa totali i këtij pozicioni eshte 3.350.20 x 0.04 =134.01 €.

Nga kjo del se Gjithsejt poz.1.1 = 67.004,00€ + 134,01€ = 67.138.01€.

1.2-poz.9 -

9	**Material tjeter lidhes I pa perfshir ne paramas 5% nga totali I kesaj pike**	5% 0.04		
		Gjithsej poz 1.2		35.915.00 €

Ne kete pozicion eshte kerkuar qe çmimi njësi te jetë 5% nga totali i të gjitha pozicioneve të mësipërme. Prandaj meqenese totali i te gjitha pozicioneve te mesiperme eshte 35.915,00 €, eshte shume e lehte qe ky Çmim te nxirret. Pra 5% e 35.915,00 = 1.795.75. Dmth çmimi njësi i poz 1.2.9 është 1.795,756, ndersa totali i këtij pozicioni eshte 1.795.75 x 0.04 =71,83 €

Nga kjo del se Gjithsejt poz 1.2 = 35.915,00€ + 71,83€ = 35.936.33€.

1.7-poz.10

10	***Material tjeter lidhes 5% nga totali I kesaj pike***	***5 % 0.05***		
		Gjithsej poz 1.7		***55.485.00 €***

Ne kete pozicion eshte kerkuar qe qmimi njesi te jete 5% nga totali I te gjitha pozicioneve te mesiperme. Prandaj me qense totali I te gjitha pozicioneve te mesiperme edhete 55.485,00 € eshte shume e lehte qe ky Çmim te nxirret. Pra 5% e 55.485.00 = 2.774,25. Dmth Çmimi njësi i poz1.7.10 është 2.774,256, ndersa totali i këtij pozicioni eshte 2.774,25 x 0.05 =138,71 € Nga kjo del se Gjithsejt poz 1.7 = 55.485,00€+ 138,77 €= 55.629.71€

2.2-poz.12

12	***Material I nevojshem per montim (lidhese plastike per kabllo, labela identifikuese etj) 10% nga totali I kesaj pike***	***10%***	***0.07***	
		Gjithsejt poz 2.2		***64.550,00 €***

Ne kete pozicion eshte kerkuar qe Çmimi njësi te jetë 10% nga totali i të gjitha pozicioneve të mësipërme. Prandaj meqenese totali i te gjitha pozicioneve te mesiperme eshte 64.550,00 €, eshte shume e lehte qe ky Çmim te nxirret. Pra 10% e 64.550,00 = 6.455,00. Dmth Çmimi njësi i poz 2.2.12 është 6.455,00 €,ndersa totali i këtij pozicioni eshte 6.455,00 x 0.07 =451.85 €

Nga kjo del se Gjithsejt poz 2.2 = 64.550.006 + 451,856 = 65.001,85 €.

2.3-poz.10

10	***Material I imet lidhes dhe montues I pa specifikuar 10 % nga totali I kesaj pike***	***10%***	***0.07 %***	
			Gjithsejt poz 2.3	***80.888.00€***

Ne kete pozicion eshte kerkuar qe Çmimi njësi te jetë 10% nga totali i të gjitha pozicioneve të mësipërme. Prandaj meqenese totali i te gjitha pozicioneve te mesiperme eshte 80.883,00 €, eshte shume e lehte qe ky Çmim te nxirret. Pra 10% e 80.888,00 = 8.088,30. Dmth Çmimi njësi i poz 2.3.10 është 8.088,80€, ndersa totali i këtij pozicioni eshte 8.088.80 x 0.07=566.22 €

Nga kjo del se Gjithsejt poz 2.3 = 80,888,00€ + 566,22€ = 81.454,22€

2.4-poz 2.4

4	***Material I imet lidhes dhe montues I pa specifikuar 5 % nga totali I kesaj pike***	***5%***	***0.03 %***	
			Gjithsejt poz 2.4	11.380,00€

Ne kete pozicion eshte kerkuar qe Çmimi njësi te jetë 5% nga totali i të gjitha pozicioneve të mësipërme. Prandaj meqenese totali i te gjitha pozicioneve te mesiperme eshte 11.330,00 €, eshte shume e lehte qe ky Çmim te nxirret. Pra 5% e 11.380,00 = 569,00. Dmth Çmimi njësi i poz2.4.4 është 569,00€, ndersa totali i këtij pozicioni eshte 569,00 x 0.03 = Nga kjo del se Gjithsejt poz 2.4 =

11.380.006 + 17,07ë = 11.397.07 €.

2.5-poz.12

12	***Material I imet lidhes dhe montues I pa specifikuar 5 % nga totali I kesaj pike***	*5%*	*0.04 %*	
			Gjithsejt poz 2.5	74.123,00€

Ne kete pozicion eshte kerkuar qe çmimi njësi te jetë 5% nga totali i të gjitha pozicioneve të mësipërme. Prandaj meqenese totali i te gjitha pozicioneve te mesiperme eshte 74.123,00 €, eshte shume e lehte qe ky Çmim te nxirret. Pra 5% e Z4.123,00 = 3.706.15. Dmth Çmimi njësi i poz 25.12 është 3.706.15ë, ndersa totali i këtij pozicioni eshte 3.706.15 x 0.04 = Nga kjo del se Gjithsejt poz 2.5 = 74.123,00€ + 148,25€ = 74.271,25€.

2.6-poz.15

15	***Material I imet lidhes dhe montues I pa specifikuar 5 % nga totali I kesaj pike***	*5%*	*0.04 %*	
			Gjithsejt poz 2.6	122.475,00€

Ne kete pozicion eshte kerkuar qe çmimi njësi te jetë 5% nga totali i të gjitha pozicioneve të mësipërme. Prandaj meqenese totali i te gjitha pozicioneve te mesiperme eshte 122.475,00 €, eshte shume e lehte qe ky Çmim te nxirret. Pra 5% e 122.475,00 = 6.123,75. Dmth Çmimi njësi i poz 2.6.15 është 6.123,75€, ndersa

totali i këtij pozicioni eshte 6.123,75 x 0.04 =244,95€. Nga kjo del se Gjithsejt poz 2.6 = 122.475,00€ + 244,95€ = 122.719,95€.

3.1-poz. Fundit

3.1	***Material I imet lidhes dhe montues I pa specifikuar 10% nga totali I kesaj pike***	*10%*	*0.07 %*	
			Gjithsejt poz 3	46.730.70€

Ne kete pozicion eshte kerkuar qe çmimi njësi te jetë 10% nga totali i të gjitha pozicioneve të mësipërme. Prandaj meqenese totali i te gjitha pozicioneve te mesiperme eshte 122.475,00 €, eshte shume e lehte qe ky Çmim te nxirret. Pra 10% e 46.730, 70 = 4.673.07. Dmth Çmimi njësi i pozite fund. 3.1 është 4.673.07€, ndersa totali i këtij pozicioni eshte 4.673.07 x 0.07 =327,11€ Nga kjo del se Gjithsejt poz 3 = 46.730,70€ + 327.11€ = 47.057.81 €

SQARIM :Totali I ndryshimit per te gjitha pozicionet eshte 2.100.00€.

Prandaj edhe njeher ju sqarojme se meqenese ne keto pozicione nuk eshte kerkuar qe te jepet ndonje çmim i cili duhet te caktohet nga ne si OE, por vetem eshte dashur qe te behet nje kalkulim per nxjerrjen e ketij qmimi dhe meqenese kjo ka mund të korrigjohen pa ndryshuar kushtin material apo aspekin e tenderit ne fjalë konsiderojm se AK eshte dashur qe kete ta beje gjate fazes se vleresimit ose nese kjo ka qene e paqarte per AK-ne eshte dashur qe konfrom nenit 72 te LPP-se te kerkoje sqarime nga ne si OE. Me qellimin e argumentimit sa me te sakte te ketij pretendimi te AK-se per eleminimit tone ne kemi kerkuar nga KRRP-ja nje sqarim te sakte ne lidhje me kete dhe te njejtin na ka ofruar nje interpretim me te cilin KRPP konsideron siq citoj: "Kështu që per këte rast KRPP konsideron se AK,

mund ta konsideroj si devijim te vogel si që citohet në piken (ii) te nenit 59 te par 4 (ii) permban vetem devijme te vogla qe nuk mund te shkakotjn ndryshime material".

(Bashkangjitur do te gjeni pyetjen dhe interpretimin e KRPP-se per kete arsye te pretenduar nga AK-ja per eleminim). Me qellimin e vetem qe te mos vazhdohet tutje me kete lloj vleresimi te papergjegjshem nga AK deshiroj te ju rikujtoj se: "Mbështetur ne dispozitat e LPP-se dhe legjislacionit tjetër ne fuqi për prokurim publik, i vetmi institucion i cili është kompetent dhe i autorizuar për te mbikëqyrur funksionimin e sistemit te prokurimit publik ne Kosove është KRPP. Vendimet dhe rekomandimet e KRPP-se dhe të OSHP-ës lidhur me zbatimin e dispozitave te LPP-se kane karakter obligativ për Autoritete Kontraktuese (kuptohet ne_aspektin legjislativ)". Referohu pyetjes 31 ne webfaqen e KRPP-se.

Arsyeja e 2-te e pretenduar nga AK-ja:

- Formularin e tenderit nuk e kanë nënshkruar dhe vulosur te gjithë anëtarët e konzorciumit.

Sqarim:

Ne si grup i OE-ve dhe si OE secili veq e veq kemi plotesuar, vulosur dhe nenshkruar te gjitha deklaratat e nevojshme per krijim e grupit te OE dhe gjithashtu ky grup i OE-ve e ka autorizuar kompanine Alko-Impex si partner kryesor per te vepruar ne emer te grupit dhe nuk qendron arsyetimi i juaj i pretenduar se kinse nuk eshte plotesuar si duhet Formulari i Tenderit sepse ne kete formular askund nuk kerkohet qe te nenshruhet ose te vuloset ky formular nga te gjithe anetaret e grupit por vetem nga personi i autorizuar e qe ne kete rast eshte OE Alko-impex ose drejtori i saj Imer Ademi. Konsiderojme se ky arsyetim i dhene nga AK-ja eshte absolutisht i paqendrueshem madje konsiderojme se eshte i qellimshem. (Bashkangjitur do te gjeni nje kopje te Formularit te Tenderit, deklaratat per krijimin e grupit te OE-ve & deklarat nen betim te nenshkruara dhe vulosura nga anetaret e konzorciumit)

Bazuar ne gjithqka qe kemi sqaruar dhe argumentuar me larte ne lidhje me arsyet e pretenduara te eleminit tone, konsiderojme se AK-ja ka vepruar ne kundershtim me LPP-ne, prandaj kerkojme qe gjate fazes se shqyrtimit te ankeses sone tek AK-ja te behen sqarimet dhe korigjimet e nevojshme dhe oferta jone te shpallet e pergjegjshme ne harmoni te plote me te dispozitat e LPP-se dhe të bazohen në qëllimin e tij të përcaktuar me paragrafin 1 të nenit 1, si në vijim, citoj: " Qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë..." Po ashtu sipas paragrafit 1 të nenit 6 të këtij ligji, të gjitha autoritetet kontraktuese janë të obliguara që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike njëkohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit. Sipas nenit 59 të këtij ligji dhe nenit 35 të Udhëzuesit Operativ për Prokurimin Publik vlerësimi i tenderëve është kompetencë dhe përgjegjësi e plotë e autoritetit kontraktues. Autoriteti kontraktues autorizohet të bëjë vlerësimin e tenderëve në pajtim me këtë ligj, si dhe në pajtim me të gjitha dispozitat e legjislacionit dytësor të nxjerrë nga KRPP në bazë të autorizimeve që i janë dhënë me këtë ligj. Megjithatë, lidhur me kërkesat e parashtruara për kualifikimin e ofertuesve (të lidhura me nenin 65-70 të LPP-së), AK, gjatë vlerësimit mund të kërkojë nga ofertuesi sqarim të tenderëve, por pa ndonjë ndryshim të kushtevc materiale ose aspekte të tenderit.(Nenet 59.4 dhe 72 të LPP-së) Në diskrecion të Autoritetit Kontraktues, në pajtim me nenin 59 dhe nenin 72 të LPP, por edhe duke u mbështetur ne praktikat e

mira ndërkombëtare ne prokurim publik, autoriteti kontraktues mund me shkrim të kërkojë nga një tenderues që të sigurojë një sqarim me shkrim mbi cilindo nga aspektet e tenderit të tij, në mënyrë që të ndihmojë në ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e tenderëve. Me fjalë të tjera, lejohet qe një autoritet kontraktues gjatë vlerësimit, kur informacioni apo dokumentacioni që duhet të dorëzohet nga operatorët ekonomikë është ose duket të jetë io i plotë ose i gabuar, ose kur mungojnë dokumentet specifike, autoritetet kompletojnë informacionin apo dokumentacionin e duhur brenda një afati te caktuar kohor, me kusht që kërkesat e tilla të bëhen në përputhje të plotë me parimet e trajtimit të barabartë dhe transparencës. Autoriteti kontraktues mund të ftojë operatorët ekonomik për të plotësuar apo të qartësojë certifikatat dhe dokumentet e paraqitura në pajtim me nenet 65-71 të këtij ligji. Sigurimi i informacionit qe mungon ose ofrimi i informacionit do të aplikohet vetëm për dokumentet ekzistenca e të cilave është e fiksuar paraskadimit të afatit për dorëzimin e tenderëve, dhe mund të verifikohet në mënyrë objektive. Prandaj meqenese ne kemi ofruar çmimin me te lirë ne raport me te gjithe ofertuesit e tjere konsiderojme se AKja ne pajtim me kriterit e dhenjes se kontrates i cili eshte "Tenderi i përgjegjshëm me Çmimin më te ulët" duhet te na rekomandoje neve per dhenje te kontrates.

Prandaj meqenese ne si OE kemi ofruar çmimin me te lire ne raport me te gjithe ofertuesit e tjere kerkojme nga OSHP qe ta aprovoi si te bazuar ankesen tone dhe kete aktivitet te prokurimit ta ktheje ne rivleresim duke e detyruar AK-es qe me qellimin e vetem te ruajtjes se parase publike te marre per baze interpretimin e KRPP-se i cili eshte i dhene ekzkluzivisht per rastin konkret.

Pikat e Ankesës nga OE **"Arbëria Com"** - *dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues:107/17*

Neni 7 Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi dhe Transparenca.

Neni 6 Ekonomiciteti dhe Efikasiteti.

Neni 10 Mjetet për promovimin e Transparencës

Neni 9 Përcaktimi i nevojave që duhet përmbushur.

Neni 59 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve

Neni 65 Pranueshmëria e Kandidatëve ose Tendejtuesve

Neni 68 Gjendja Ekonomike dhe Financiare.

Neni 69 Aftësia Teknike dhe/ose Profesionale.

Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet:

- Shpallja e operatorit të papërgjegjshëm si fitues - "Favor Ing" & "As Ing" & "Çlirimi" Nga Korishë Prizren

Ne. NNP Arberia Com jemi operator ekonomik i përgjegjshëm që i kemi plotësuar të gjitha kushtet dhe kriteret sipas ligjit dhe dosjes së tender dhe AK do të duhej të na shpërblente si fitues i tenderit e assesi të shpallte një operator të pasuksesshëm sepse as fituesi i shpallur Konzorciumi "Favor Ing" & "As Ing" & "Çlirimi"- Prizren dhe as Konzorciumi NNP "Standard" & "ALB -Architect shpk"- Prishtinë nuk janë të përgjegjshëm.

Operatori ekonomik - Konzorciumi "Favor Ing" & "As Ing" & "Çlirimi"- Prizren - i shpërblyer me kontratë nga AK - Ministria e Shëndetësisë është tërësisht i papërgjegjshëm dhe AK do të duhej ta eliminonte si të papërgjegjshëm e assesi ta shpallte fitues në mënyrë të kundërligjshme.

1. Vendimi i datës 27.01.2017 i OSHP-ës vërteton se Konzorciumi "Favor Ing" & "As Ing" & "Çlirimi"- Prizren nuk kanë qenë të përgjegjshëm me arsyetim se Konzorciumi "Favor Ing" & "As Ing" & "Çlirimi"- Prizren nuk ka realizuar punë të cilat kanë qenë sipas kërkesës të dosjes të tenderit dhe ju mungon eferenca në ndërtim në vlerë prej 5,000,000 Euro,

Citojmë vendimin e OSHP-ës në faqen 9, paragrafi 5 dhe 6:

a - paragrafi 5 "ka kryer punime siç janë anekse, punimet për vendosjen e pajisjeve si: qilerat, pompat e ujit dhe punimet në nënkulm si hapësirë për vendosjen gazit medicinal".

b - paragrafi 6 "gjithashtu paneli shqyrtues se AK me datë 16.01.2017 ka kërkuar sqarime shtesë nga Spitali Sheik Zayed - Vushtrri, se a është bërë pranimi teknik i projektit gjegjësisht pranim dorrëzimi i punëve ne rënovimin e spitalit, ndërsa me të njejtin datë kanë marrë përgjigje nga Drejtori Z. Mujë Ferati ku sqarohet se pranimi teknik i punëve të kryera në renovimin e Spitalit të Vushtrrisë nuk është bërë. Prandaj referenca nga anëtari i konzorciumit Favor Ing për projektin "Renovation and refurbishment of Khalifa Bin Zayed hospital in Vushtrri" nuk mund të merret parasysh pasi që në dosje të tenderit dhe tek njoftimi për kontratë shkruan decidivisht se "Nuk pranohen projektet e papërfunduara-pa procesverbal të pranimit teknik". Prandaj duke u bazuar në këto dëshmi rrjedhimisht viem në përfundim se ky operatorë ekonomik është i papërgjegjshëm."

PROVË SHKRESORE: Vendimi i OSHP-ës të datës 27.01.2017

PROVË SHKRESORE. Kopjet nga Kontrata dhe referenca nga Donatori konfirmojnë se është fjala për renovim dhe ngjyrosje të ndërtesës ekzistuese.

PROVË SHKRESORE. Mungon Pranimi teknik të punëve të renovimit dhe ngjyrosjes të ndërtesës.

2. Operatori ekonomik Konzorciumi "Favor Ing" & "As Ing" & "Çlirimi"- Prizren figuron se ka borxhe të pashlyera në ATK që bie ndesh me LPP nenini 65 paragrafi 4.81 dhe 4.92.

PROVË SHKRESORE: Deklarata e ATK-ës

3. Operatori ekonomik "Favor Ing" & "As Ing' & "Çlirimi"- Prizren i mungon deklarata "Deklaratë e operatorit ekonomik se është i përgatitur qe ta kryej ndërtimin e objektit në tërësi për një afat kohor maksimumi 600 ditë pune" sic kerkohet me DT pika 9.1 - evidenca 4-të.

4. Të gjitha deklaratat janë të nënshkruara vetëm nga NPN "Çlirimi" dhe jo nga të gjithë anëtarët e konzorciumit siq kërkohet në dosje të tenderit". Si dhe mungon Emri dhe Mbiemri i personit të autorizuar dhe nënshkrimi.

PROVË SHKRESORE: Dosja e Konzorciumit.

5. ISO Standardi 9001 nuk është nga NPN "Çlirimi" Biznes Individual por është nga "Çlirimi" sh.p.k. me numër biznesi 70724405.

PROVË SHKRESORE:ISO standardi 9001-Kopja e bashkëngjitur.

6. Mungon deklarata e personit të autorizuar të nënshkruar dhe të vulosur nga anëtarët e konzorciumit.

PROVË SHKRESORE: Dosja e Konzorciumit

7. Të gjitha Referencat nga NPN "Çlirimi" kemi të bëjmë me dy persona juridik të ndryshëm.

PROVË SHKRESORE. Bizneset e regjistruara ne MTI -kopje nga ééé.arbk.org

8. Në CV të Projekt Menaxherit mungon përvoja profesionale 8 vjeqare në

ndërtim.

PROVË SHKRESORE: CV të Inxh të Ndërtimit - Konstruktiv

9. Në CV të Inxhinierit të Energjitikës nuk ka përvojë profesionale në ndërtim para vitit 2013. Përvoja e tij në KEK vërteton se nuk ka përvojë në objekte ndërtimore të larta publike apo të ngjajshme.

PROVË SHKRESORE: CV të Inxh të Energjitikës

10. Mungon plani dinamik i hollësishëm i realizimit të punëve.

II. Zgjedhja e operatorit si të Përgjegjshëm të Konzorciumit NNP "Standard" &"ALB -Architect shpk" Ne. NNP Arberia Com jemi operator ekonomik i përgjegjshëm që i kemi plotësuar të gjitha kushtet dhe kriteret sipas ligjit dhe dosjes së tender dhe AK do të duhej të na shpërblente si fitues i tenderit e assesi të shpallte një operator të pasukseshëm.

I. Operatori ekonomik - Konzorciumi NNP "Standard" & "ALB -Architect shpk"- Prishtinë i zgjedhur si operatorë i përgjegjshëm nga AK- Ministria e Shëndetësisë; është tërësisht i papërgjegjshëm dhe AK do të duhej ta eliminonte si të papërgjegjshëm. 1. Operatori ekonomik - Konzorciumi NNP "Standard" & "ALB - Architect shpk"- Prishtinë në vendimin e OSHP-ës vërteton se nuk ka referenca ndërtimi si dhe i mungon deklarata lidhur me afatin 600 ditor për kryerjen e punimeve.

PROVË SHKRESORE: Vendimi i OSHP-ës të datës 27.01.2017, faqe 11 , paragrafi 2.

2. Operatori ekonomik - Konzorciumi NNP "Standard" & "ALB - Architect shpk"- Prishtinë e ka dorrëzuar Vërtetimin tatimor nga ATK ku tregon se ka borxhe tatimore apo obligime tatimore të pashlyera dhe nuk figuron asnjë marrëveshjë për shlyerje të borxheve.

PROVË SHKRESORE. Të bashkëngjitur-kopje

3. Operatori ekonomik - Konzorciumi, NNP "Standard" & "ALB - Architect shpk"- e ka dorrëzuar Vërtetimin tatimor nga ATK vetëm për vitin 2016 ndërsa mungojnë për vitet 2013, 2014 dhe 2015 ku kërkohet sipas dosjes të tenderit.

4. Operatori ekonomik - Konzorciumi NNP "Standard" & "ALB - Architect shpk"- Prishtinë, i mungojnë qarkullimet financiare për vitet 2013, 2014 dhe 2015 ku kërkohet sipas dosjes të tenderit.

Prandaj duke marrë parasysh të gjitha provat dhe faktet si dhe në përputhje me dispozitat ligjore të LPP ne japim këtë:

PROPOZIMI:

Ne i propozojmë OSHP-ës, që pasi t'i ketë analizuar të giitha shkresat e lëndës, dosjen e tenderit dhe korrespondencat e këtij aktiviteti të prokurimit, të aprovojë këtë ankesë si të bazuar dhe të nxjerrë:

V E N DIM

Me të cilin AK Ministria e Shëndetësisë anulon shpalljen e fituesit dhe lëndën e kthen në rivlerësim dhe t'i respektoi dispozitat ligjore dhe dosjen e tenderit.

Pikat e Ankesës nga OE **"Al Trade"** - *dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues:109/17*
Neni 7 Barazia ne Trajtim/Jo- Diskriminimi,

Neni56 i LPP-se - Dispozita e Përgjithshme mbi përzgjedhjen e pjesëmarrësve dhe dhënien e kontratës

Neni 59 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve

Neni 60 Kriteret për Dhënien e Kontratës

Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet:

Kompania jone nuk pajtohet me vlersimin e AK pasiqe mendojme qe jemi diskriminuar duke mos u trajtuar njëjte sikurse operatori i rekomanduar për kontrate sepse operatori i rekomanduar për kontrate nuk është i përgjegjshëm dhe se nuk i ka te plotësuara disa nga kushtet qe jane kerkuar ne FDT-se.

Pasi kemi kontrolluar dosjen e Konsorciumit ne prani te komisionit, kemi vërejtur se:

1 Ne nenin 9.1 te FTD-s kërkohet qe Operatori Ekonomik te ketë te përfunduar një object shëndetësorë me vlere investive ne ndërtim jo me te vogël se 500 mijë euro.

Ne listën e dorëzuar te projekteve te kryer nga kompania CLIRIMI nuk ka asnjë objekt shëndetësor qe kap vlerën 500 mijë euro, ndërsa partneri i tyre "NPN Favor-ING" ka te prezantuar projektin: "Renovation and refurbishment of khalifa bin zayed hospital invushtrri" ky projekt ka te beje me "RENOVIM"jo me "NDËRTIM". Ku ne baze te ligjit te ndërtimit neni 3 pika 1.11 Riparimi nënkupton "Kthimi i një objekti ne kushte te pranueshme duke bere ripërtëritjen, zëvendësimin, apo rregullimin e pjesëve te dëmtuara ose te degraduara".

Po ashtu ne baze te VENDIMIT te nxjerra nga PANELI SHQYRTUESI PROKURIMIT, 21.01.2017, me nr. PSH 442/16; 443/16; 445/16 ne faqen 9 dhe 10 te këtij VENDIMI citohet si ne vijim:

Paneli shqyrtues duke u bazuar ne te gjitha dëshmitë, argumentet ne lidhje me këtë aktivitet te prokurimit, raportin e ekspertit shqyrtues, përgjigjet e palëve ne procedure, dëshmitë e prezantuara dhe diskutimet e bëra ne seancën dëgjimore, konstaton se konsorciurni ankues "FAVOR ING&ASING&CLIRIMI" nuk e ka plotësuar kërkesën e autoritetit kontraktues përkitazi me kapacitetin teknik dhe profesional ku është kërkuar qe "operatori ekonomik duhet te ofroje dëshmi se ka përfunduar me sukses projekte ne lëmin e ndërtimtarisë gjate tri viteve te fundit marr se bashku (2013, 2014, 2015 pranohen edhe te 2016) ne vlere prej 5 milion euro. Kërkohet te ketë te përfunduar se paku një objekt shëndetësor me vlere investive ne ndërtim jo me vogël se 500, 000 00 €. Nuk pranohen projektet e papérfunduara-pa procesverbalte pranimit teknik",

Panel shqyrtues duke pasur parasysh edhe kërkesën e autoritetit kontraktues te dt.04.11.2016 drejtuar konsorciumit ankues ne fjale për sqarime shtese, si dhe përgjigjen e konsorciumit ne fjale te dt.05.11.2016 ne lidhje me projektin "Renovation and Refurbishment of Khalifa Bin Zayed Hospitalin Vushtrri", konstaton se ky konsorcium ne këtë projekt nuk ka kryer plotësisht punime te ndërtimtarisë ashtu siç; ka qene kërkesa decidive e autoritetit kontraktues. Por ashtu siç, e kane bere përshkrimin edhe vete konsorciurni ankues dhe ne vete paramasen qe e ka dërguar tek autoriteti kontraktues me rastin e sqarimeve shtese, vërehet qarte se ky konsorciurn ne projektin e lartpërmendur ka kryer punimet siç; janë anekse, punimet për vendosjen e pajisjeve si: qilerat, pompat e ujit dhe punimet ne nënkulm si hapësira për vendosjen e gazit medicional. Gjithashtu panel i shqyrtues konstaton se autoriteti kontraktues me dt: 16.01.2017 ka kërkuar sqarime shtese nga Spitali Sheik Zayed-Vushtri, se

a është bere pranimi teknik i projektit gjegjësisht pranirn dorëzim i punëve ne renovimin e spitalit, ndërsa me te njëjtën date kanë marr përgjigje nga Drejtori z. Muje Ferati ku sqarohet se pranimi teknik i punëve te kryera ne renovimin e spitalit te Vushtrrisë nuk është bere. Prandaj referenca e ofruar nga anëtari i konsorciumit Favoring për projektin "Renovation and Refurbishment of Khalifa Bin Zayed Hospitalin Vushtrri" nuk mund te merret parasysh, pasi qe ne dosje te tenderit dhe tek njoftimi për kontrate shkruan decidivisht se "Nuk pranohen projektet e paperfunduara-pa procesverbal te pranimit teknik ". Prandaj duke u bazuar ne këto dëshmi rrjedhimisht viem ne përfundim se ky operator ekonomik është i papërgjegjshëm, pasi qe nuk ka ofertuar konform kërkesave te autoritetit kontraktues përkitazi me kapacitetin teknik/profesional. Ndërsa sa i përket mendimit te ekspertit shqyrtues se te kontratat për pune hyjnë: ndërtime, restaurime, riparime ose demolime te objekteve, hapësirave, struktura te inxhinierisë civile ose ndonjë pjese tjetër, panel i shqyrtues konstaton se kërkesa e autoritetit kontraktues nuk ka qene qe te merret për baze lloj i kontratave sipas kodit, por kërkese e qarte dhe decidive ka qene qe te ofrohen dëshmi për projekt ne lëmin e ndërtimtarisë, madje kërkese e veçantë ka qene qe OE te kenë te përfunduar se paku një objekt shëndetësore me vlere investive ne ndërtim, jo me te vogël se 500.000.00 €. Pra autoriteti kontraktues kërkesën e ka pasur te specifikuar qe ne kuadër te kodit për pune te ofrohen dëshmi për ndërtimtarin objekte shëndetësore. Ndërsa lidhur me këtë kërkesë nuk ka pasur ndonjë ankese ne OSI-IP, gjate fazës se tenderimit. Prandaj duke pasur parasysh dëshmitë e lartpërmendura paneli shqyrtues konstaton se ky operator ekonomik ankues është i papërgjegjshme dhe nuk ka mundur te dëshmojë interes juridik material ne këtë aktivitet te prokurimit konform nenit 1 1111 paragrafi I pika 1.5 dhe 1.8 te LPP-se lidhur me nenin 4.1.26 te LPP- se pasi qe ne asnjë variant OE ankues nuk ka mundur te përshkruajë mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktoje dëme materiale.

2.Ne FTD Neni 9.1 Kërkesa mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale Kërkesa 2, kërkesat lidhur me Stafin Profesional për Projekt, Evidenca 2:

Projekt Menaxheri

Projekt Menaxheri i Kompanisë ÇLIRIMI- Bexhet Baftjaraj i propozuar nga konsorciumi i kompanive, nuk ka referenca te lëshuara nga punëdhënësit, as edhe për një projekt, e vetmja reference qe është ne dokumentet e prezantuara është referenca e lëshuar nga kompania CLIRIMI ku janë te cekura 5 projekte. Projekt Menaxheri nuk ka reference nga autoriteti kontraktues për projektet e listuara ne referencën e CLIRIMIT- p.sh

Projektet: "Ndërtimi i qendrës se Paraburgimit ne Gjilan" nuk ka reference "Ndërtimi i objektit te ri te Universitetit Publik te Prizrenit" nuk ka reference pra Projekt Menaxherit i mungon emri ne pranime teknike te paraqitur ne dosjen e dorëzuar, dhe nuk posedon asnjë reference lidhur me projektet e cekura nga Autoritet Kontraktuese.

Inxhinieri i Hidros - Gafurr Dakaj nuk është prej muajit 4 aktiv primar ne firme mirëpo është si i punësuar sekondar, kjo mund te vërtetohet nga listat e pagave te dorëzuar ne dosje te tenderit.

Inxhinieri i Elektrikes Kompanisë ÇLIRIMI- Xhelal Kuak-2015-2014-2013 Mungon ne lista te pagave- kurse ka deklaruar se punon prej 2013-2016 ne CV-in e tij ne dosje te dorëzuar.

Inxhinieri i Ndërtimtarisë - Kompania FAVORING Halil Bytyqi i prezantuar nga kompania FAVORING nuk është ne liste te pagave te ATK-s 2016.

Inxhinier i Makinerisë- Kompanisë FAVOR-ING- Albert Bylykbashi nuk i ka 5 vite përvojë te

punës ashtu siç kërkohet ne FTD, mirëpo nuk ka paraqitur edhe referenca qe tregojnë përvojën e punës, e gjitha çka është prezantuar ne dosje është një CV- ku janë te cekur data e vite mirëpo nuk është e mjaftueshme.

Inxhinieri i Ndërtimtarisë-Kompania AS-ING - Ismet Berisha ka vetëm një reference 2012, ku nuk specifikohet ne veçanti se ne çfarë projekti ka qeni angazhuar, si dhe nuk ka dokumente mbështetëse nga autoriteti kontraktues, apo se paku te jete prezent ne ndonjë pranim teknik te dorëzuar ne dosje. Po ashtu Ismet Berisha nuk gjendët ne listën e pagave te ATK-s vitit 2016.

Inxhinier i Hidros- Kompania AS-ING - Izahir Kukaj, ka vetëm një reference ne 2010 ku nuk specifikohet ne veçanti se ne çfarë projekti ka qen i angazhuar, si dhe nuk ka dokumente mbështetëse nga autoriteti kontraktues, apo se paku te jete prezent ne ndonjë pranim teknik te dorëzuar ne dosje. Ne CV-in e tij ka deklaruar se vendi i punës është Kuvendi Komunal ne Kaçanik nga 2014 e ne vazhdim ndërsa tek kompania AS-ING është me rroge sekondare, dhe ne kontrate ka te paraqitur vetëm 40 ore për muaj.

Inxhinier i Elektrikes- Kompania AS-ING, Kujtim Suka, ka paraqitur vetëm një reference ku nuk specifikohet ne veçanti se ne çfarë projekti ka qen i angazhuar, si dhe nuk ka dokumente mbështetëse nga autoriteti kontraktues, apo se paku te jete prezent ne ndonjë pranim teknike ku do te figuronte emri i tije si pjesëmarrës ne realizimin e punimeve, Kujtim Suka tek kompania AS-ING është me rroge sekondare, dhe ne kontrate ka te paraqitur vetëm 40 ore për muaj.

Inxhinier i Makinerisë- Kompania AS-ING, Eqrem Kryeziu, ka paraqitur dy referenca njërën nga kompania NBT-ING dhe kompania AS-ING, këto referenca nuk posedojnë data për çfarë periudhe kohore i janë lëshuar këto referenca. Po ashtu nuk ka dokumente mbështetëse nga autoriteti kontraktues, apo se paku te jete prezent ne ndonjë pranim teknike ku do te figuronte emri i tije si pjesëmarrës ne realizimin e punimeve, Eqrem Kryeziu tek kompania AS-ING është me rroge sekondare, dhe ne kontrate ka te paraqitur vetëm 40 ore për muaj.

Inxhinier i Arkitekturës-i Kompanisë AS-ING Sami Hoxha ka dy referenca njërën nga kompania NBT-ING dhe kompania AS-ING, këto referenca nuk posedojnë data pra nuk dihet se për çfarë periudhe kohore i janë lëshuar këto referenca. Po ashtu nuk ka dokumente mbështetëse nga autoriteti kontraktues, apo se paku te jete prezent ne ndonjë pranim teknike ku do te figuronte emri i tije si pjesëmarrës ne realizimin e punimeve, Sami Hoxha tek kompania AS-ING është me rroge sekondare, dhe ne kontrate ka te paraqitur vetëm 40 ore për muaj.

Vërejtje: Kontratat e paraqitura nga kompania AS-ING ne dosje nuk janë me standarde se si kërkohen me rregullore dhe ligjet e Kosovës.

3.Ne Seksionin II Fleta e te dhënave te Tenderit ne neni 7.1 kërkesa 4 ku ceket se: "Operatori Ekonomik duhet te dëshmoj se është i certifikuar me Certifikate ISO 9001:2008" nga verifikimi i dokumentit te siguruar nga kompania NPNT"CLIRIMI" ne dosjen e dorëzuar te tyre, certifikata PERSISTEMIN E MENAXHIMIT TE CILESISE EN ISO 9001:2008, me numër AQS/Q/6932016 nuk është valide, verifikimi i saj mund te bëhet ne faqen.

http://www.aqscert.org/al/klientet/ për gjuhe Shqipe Verifikimi http://www.aqscert.org/clients/ për gjuhe Angleze verifikimi

Kërkimi i subjektit ne ueb faqen ka dy elemente te detyrueshëm për plotësim; Emrin e subjektit dhe nr. certifikatës. Vërejtje: Duhet cekur se partneret tjerë te këtij konsorciumi ne dosjen e dorëzuar nuk kanë

paraqitur certifikata ISO 9001:2008.

Edhe ne kete pike kemi dyshime te medha pasiqe kemi verejtur qe Certifikata EN ISO 9001:2008 e leshuar nga AQSCERT nuk figuron fare ne sisten te Subjektit qe e ka leshuar kete Certifikate. Kerkojme nga Ju qe te kontrolloni dhe te siguroheni qe Certifikata e ofruar si deshmi nga OE-ja eshte valide.

4.Po ashtu ne baze te rregullores per prokurimit publik F03 Autoriteti Kontraktues ka bere shkelje te refuzimit te kerkeses per shqyrtim ne baze te Nenit 7 dhe Nenit 8, kur forma e mbushjes se raportit te shqyrtimit te kereksese nuk eshte perpiluar ne mnyre te rregullut nga zyrtaret e prokurmit te AK.

5.Duke u bazuar ne pergjigjien e AK per eleminimim ku ceket se:

Ju jeni diskualifikuar për këto arsye:

Lista e projekteve te përfunduara ne lëmin e ndërtimtarise, gjatë tri viteve të fundit marr se bashku (2013, 2014, 2015, pranohen edhe te 2016) në vlerë prej 5 milion euro. Kërkohet te ketë te përfunduar nje ose me shumë objekte shëndetësore me vlere te pergjithshme investive ne ndërtim jo me te vogël se 500,000.00 € (lista kerkohet ne origjinale nenshkruar dhe e vulosur).

Lista duhet te permbaje:

- Emrin e punedhenesit,
- emrin e projektit,
- vlerën e projektit,
- datën e përfundimit,
- vendndodhjen e projektit, emri dhe mbiemri i personit kontaktues/personi përgjegjës i autoritetit, me te dhënat e tijë te kontaktit: nr. telefoni, e-maili etj,

Pergjigje;

- Oferta "Al Trade" nuk e ka plotësuar kriterin: Lista e projekteve te përfunduara ne lëmin e ndërtimtarisë, gjatë tri viteve të fundit marr se bashku (2013, 2014, 2015, pranohen edhe te 2016) në vlerë prej 5 milion euro. Kërkohet te ketë te përfunduar një ose me shumë objekte shëndetësore me vlere te përgjithshme investime ne ndërtim jo me te vogël se 500,000.00€ (lista kërkohet ne origjinal e nënshkruar dhe e vulosur). OE nuk e ka dëshminë qe ka kryer pune te pranuara ne vlere prej 500,000.00 euro ne objekte shëndetësore. Dokumentet e prezantuara vërtetojim qe ne Skenderaj e ka pranim te pjesshëm qe nënkupton punët nuk janë kryer tërësisht si dhe kërkesën për pranim te punëve vet OE e ka bere për pranim te pjesshëm. Referenca për ndërtimin e spitalit te FSK-së ne Prishtinë, pas kërkesës për informate sqaruese kemi marr konfirmim qe OEAl Trade ka kryer 10% te vlerës se kontratës por vetëm furnizim e jo pune siç është kërkuar ne dosje te tenderit. Ka te dokumentuar një QKMF ne komune te Prishtinës ne vlere prej 487,986.93.

- Ne mendojme se Autoriteti Kontraktues, gjatë procedurës së prokurimit publik, ka shkelur LPP nenet lart cekura.

- Duke pasur parasysh se ne si OE i kemi prezentuar te gjitha dokumente te cilat na jan kërkuar dhe kemi plotesuar kushtet nga Fleta e te dhënave te Tenderit, te bashkangjitura mund ti gjeni listen e projekteve dhe referencave per punët e ekzekutura me lëmin ndërtimit, diçka qe është dorzuar edhe tek

AK, ku ne si OE kemi dëshmuar qe kemi kryer pune te pranuara ne vlere prej 500,000.00 euro ne objekte shëndetësore.

Përfundim:

Mendojmë se Autoriteti Kontraktues ka bere shkelje te dispozitave te LPP-se dhe neneneve te cekura me larte duke shpallur fitues kompaninë;

- Nuk ka asnjë objekt shëndetësorë me vlere investive ne ndërtim jo me te vogël se 500,000.00 €, ashtu siç kërkohet ne FTD.
- Stafi i se cilës nuk i plotëson kriteret sipas FTD
- Nuk posedon certifikatat valide te ISO 9001:2008.

Procesi i prokurimit:

Data e njoftimit për kontratë në KRPP : 14.06.2016

Lloji i procedurës së aplikuar:..... Procedurë e hapur

Lloji dhe vlera e kontratës së publikuar: .....Punë/vlerë e madhe

Afati i fundit për dorëzimin e ofertave (gjithsejtë ditë): 16.09.2016

Data e hapjes së ofertave .....16.09.2016-14:30^{h}

Kriter për dhënie të kontratës:.....*Tenderi i përgjegjshëm me çmim më të ulët*

Lloji i kontratës:.....*Kontratë Publike*

Kriteret për vlerësim

III.2)KUSHTET PËR PJESËMARRJE

III.2.1) Kërkesat e përshtatshmërisë:

1. Një deklarate e shkruar nën Betim, e nënshkruar nga tenderuesi duke përdorur formën në Aneksin 2.

2. Një dokument nga Administrata Tatimore e vendit tuaj të themelimit, se ju nuk jeni me vonesë për pagimin e tatimeve së paku deri në tremujorin e fundit para datës se publikimit të Njoftimit të Kontratës.

3. Një dokument i lëshuar nga Gjykata kompetente që vërteton se operatori ekonomik i përmbush "Kërkesat e përshtatshmërisë"- të jetë i lëshuar së paku deri në tremujorin e fundit para datës se publikimit të Njoftimit të Kontratës.

Dëshmia e kërkuar dokumentare:

1. Deklarata nën Betim (Origjinali).
2. Vërtetim i lëshuar nga Administrata Tatimore - jo me e vjeter se tre muaj.
3. Vërtetimin nga Gjykata Themelore-Departamenti për Çështje Ekonomike (kërkohet origjinal ose i vërtetuar/noterizuar nga institucioni kompetent në vendin tuaj të themelimit).

*Dokumentet **(nën 2 dhe 3)** duhet të dorëzohen **vetëm nga tenderuesi fituesi**, para publikimit të dhënies së kontratës. Në rast të dështimit në dorëzim të dokumenteve të tilla, tenderi i tyre do të refuzohet dhe AK do të vazhdojë me tenderuesin e listuar të radhës.*

III.2.2) Përshtatshmëria profesionale:

Kërkesa 1: Regjistrimi si operator ekonomik në regjistrin profesional, komercial dhe/apo regjistrin e ndërmarrjeve ne vendin e juaj te themelimit.

Kërkesa 2: Regjistrimi ne regjistrin Fiskal për kompanitë vendore;

Kërkesa 3: Regjistrimi i OE me TVSH – vetëm për kompanitë e regjistruara ne Kosove;

Kërkesa 4: OE duhet te dëshmojë se është i certifikuar me ISO 9001:2008

Dëshmia e kërkuar dokumentare:

Evidenca 1: **Certifikata e Biznesit** – kopje;

Evidenca 2: **Kopje e Certifikatës se Numrit Fiskal** – kopje;

Evidenca 3: **Kopje e Certifikatës se TVSH-se** – kopje.

Evidenca 4: **Certifikata profesionale ISO 9001:2008** (kopje e noterizuar).

III.2.3) Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

Kërkesa 1: Operatori ekonomik duhet te ofrojë dëshmi te qarkullimit financiar ne kryerjen e punimeve ndërtimore, gjatë tre viteve të fundit (2013-2014-2015, pranohen edhe te 2016) marre se bashku, në vlerë jo më pak se 5 milion euro.

Kërkesa 2: Operatori ekonomik fitues para dhënies se kontratës duhet te dëshmoje se ka ne pronësi ose me mbështetje financiare nga një banke kredibile (garancion bankar), ne vlere 1.5 milion euro, për 37 muaj.

Dëshmia e kërkuar dokumentare:

Evidenca 1: Deklaratat Tatimore nga Administrata Tatimore e Kosovës për qarkullimin financiar ne kryerjen e punimeve ndërtimore, marre se bashku për tri vitet e fundit (2013, 2014, 2015, pranohen edhe te 2016) në vlerë jo më pak se 5 milion euro, (kërkohet origjinal ose kopje e noterizuar).

Evidenca 2: Dëshmi mbi pronësinë ose Dokument garantues nga një banke kredibile për mbështetje financiare (garancion bankar), ne vlere 1.5 milion euro. Kjo kërkohet vetëm për operatorin ekonomik fitues para dhënies se kontratës, për 37 muaj.

III.2.4) Kapaciteti teknik dhe profesional

Kërkesa 1: Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses projekte në lëmin e ndërtimtarisë gjatë tri viteve të fundit marr se bashku (2013, 2014, 2015, pranohen edhe te 2016) në vlerë prej 5 milion euro. Kërkohet te ketë te përfunduar se paku një objekt shëndetësor me vlere investive ne ndërtim jo e te vogël se 500,000.00 €.Nuk pranohen projektet e papërfunduara-pa procesverbal te pranimit teknik.

Kërkesa 2: Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi qe posedon me Staf te punëtoreve dhe inxhinierve qe do te kyçen ne projekt (te përhershëm minimum 15 punëtor dhe 6 inxhinier) nga këto lami: Një inxhi. dip. I arkitekturës , Një inxhinier i dip.i ndërtimtarisë drejtimi konstruktiv, një inxhinier i dip.i ndërtimtarisë drejtimi

hidroteknik, një inxhinier i dip.i elektroteknikes, një inxhinier i dip.i makinerisë) dhe menaxheri i projektit:

Stafi profesional – inxhinieret e përhershëm janë:

1. Nje inxhi. dip. i arkitektures, me përvojë te punës profesionale min. 5 vite pas diplomimit;
2. Një inxhinier i dip.i ndërtimtarisë drejtimi konstruktiv, me përvojë te punës profesionale min. 5 vite pas diplomimit;
3. Një inxhinier i dip.i ndërtimtarisë drejtimi hidroteknik, me përvojë te punës profesionale min. 5 vite pas diplomimit;
4. Një inxhinier i dip.i elektroteknikes, me përvojë te punes profesionale min. 5 vite pas diplomimit;
5. Një inxhinier i dip.i makinerisë, me përvojë te punës profesionale min. 5 vite pas diplomimit;
6. Projekt Menaxheri, inxhinier i diplomuar nga ndonjeri profil (arkitekt, inxh. ndërtimtarisë ose inxh. i makinerisë), me përvojë te punës profesionale min. 8 vite pas diplomimit;

Kërkesa 3: OE duhet te dëshmoj se ka ne pronësi se paku këto mjete te punës për realizimin e projektit:

- 1 kamion për transport te materialit, min. 12 m3,
- 1 kamion për transport te materialit, min. 7 m3,
- Një Ekskavator, min.35t,
- Një Eskavator, min.12t,
- Kompaktesues me vibrim, min.10t,
- Kompaktesues, min. 6t

Kërkesa 4: Operatori ekonomik duhet te deklaroj se është i përgatitur qe ta kryej ndërtimin e objektit ne tersi për një afat kohor maksimumi 600 dit pune.

Dëshmia e kërkuar dokumentare:

Evidenca 1:

- Lista e projekteve te përfunduara ne lëmin e ndërtimtarise, gjatë tri viteve të fundit marr se bashku (2013, 2014, 2015, pranohen edhe te 2016) në vlerë prej 5 milion euro, se paku një objekt shëndetësor te përfunduar me vlere investive ne ndërtim jo e te vogël se 500,000.00 €, (origjinal e nenshkruar dhe e vulosur).

  Lista duhet te permbaje:

  - Emrin e punedhenesit,
  - emrin e projektit,
  - vlerën e projektit,
  - datën e përfundimit,
  - vendndodhjen e projektit,
  - emri dhe mbiemri i personit kontaktues/personi përgjegjës i autoritetit, me te dhënat e tijë te kontaktit: nr. telefoni, e-maili etj,
- Referencat/procesverbalet e pranimit përfundimtar të punëve, ku figurojne te dhenat rreth projektit dhe data e përfundimit te projektit, në vlerë te pergjithshme prej 5 milion euro.

Evidenca 2:

- Lista e ATK për stafin e përhershëm (minimum 15 punëtor dhe 6 inxhinier) – origjinal ose kopje e noterizuar. Ne ketë liste kërkohet te dëshmohet pagesa e kontributeve tatimore ne 6

mujorin e fundit te vitit 2015.

Për stafin profesional – 5 inxhinieret e përhershëm kërkohen:

- Diplomat e noterizuara;
- CV (e nënshkruar dhe e vulosur)
- Referenca nga punedhenesit per përvojën e punes profesionale min. 5 vite pas diplomimit;

Për menaxherin e projektit kërkohen këto dëshmi:

- Autorizimi për caktimin e menaxherit te projektit;
- Diploma e noterizuar;
- CV (e nënshkruar dhe e vulosur);
- Referenca nga punedhenesit per përvojën e punes profesionale min. 8 vite pas diplomimit;

Evidenca 3:

- Lista e makinerisë dhe mjeteve te punës, (origjinal e nenshkruar dhe e vulosur).
- Dokumentacioni i pronësisë – librezat e qarkullimit, per pajisjet e kerkuara.

Evidenca 4: Deklarate e operatorit ekonomik se është i përgatitur qe ta kryej ndërtimin e objektit ne tersi për një afat kohor maksimumi 600 dit pune.

Informata me rëndësi:

- Operatoret ekonomik duhet te ofrojnë vetëm dokumentet e kërkuara dhe mos ta ngarkojnë ofertën me dokumentacione tjera te panevojshme.

Autoriteti Kontraktues e rezervon të drejtën ligjore për verifikimin e të gjitha dokumenteve të ofruara tek autoritet perkates qe i lëshon këto dokumente.

Regjistri i ofertuesve sipas procesverbalit të hapjes publike:

Nr	Operatoret ekonomik	Vendi	Çmimi total për njësi €	Vërejtje
1.	"Ledi Ing"	Prishtinë	9,997,132.80€	JO
2.	**"Çlirimi"**	**Prizren**	**8,886,401.59€**	JO
3.	"Enex Trade"	Pejë	8,907,609.49€	JO
4.	"Berisha Company"	Ferizaj	10,970,615.40€	JO
5.	**"Alko-Impex"**	**Prishtinë**	**8,740,144.18€**	JO
6.	"Lesna"	Prishtinë	11,864,687.90€	JO
7.	**"Pe-Vla-Ku"**	**Prishtinë**	**9,002,174.18€**	JO
8.	"Çeta Gig"	Fushë Kosovë	10,399,949.34€	JO
9.	**"Al-Trade"**	**Prishtinë**	**9,467,720.93€**	JO
10.	"Gintas"	Istog	10,955,861.13€	JO
11.	"Fitorja"	Ferizaj	9,965,725.85€	JO
12.	**"Olti Trasing"**	**Prishtinë**	**9,574,953.84€**	JO

13.	"Kevin"	Tiranë	9,407,132.92€	JO
14.	**"Arberia Com"**	**Prishtinë**	**10,235,587.10€**	JO
15.	"Termomontimi"	Prishtinë	10,722,560.46€	JO
16.	"Euro Ing"	Rahovec	10,984,576.13€	JO
17.	"Rexha"	Prishtinë	9,740,782.07€	JO
18.	"Beni Construction"	Viti	11,373,284,30€	JO
19.	"Rukolli"	Skenderaj	9,344,067.53€	JO
20.	**"Standard"**	**Prishtinë**	**8,949,277.35€**	JO

Komisioni vlerësues pranë AK:

Përbërja dhe kualifikimi i komisionit vlerësues.

Autoriteti Kontraktues për vlerësimin e tenderëve ka caktuar komisionin në përbërje prej tre anëtarëve, si në vijim:

- Besim Bajraktari - Kryetar i komisionit
- Blerim Zeqiri - Anëtar i komisionit
- Sizajne Hoda - Anëtar i komisionit
- Pashk Buzhala - Anëtar i komisionit
- Alban Thaqi - Anëtar i komisionit

Data e mbarimit të vlerësimit: 14.03.2017

Data e nënshkrimit te raportit nga zyrtari kryesor i prokurimit:.....14.03.2017

Data e njoftimit të Dhënies së Kontratës në faqen e Krpp-së :.....21.03.2017

Sipas raportit të komisionit të vlerësimit ofertat të PËRGJEGJSHME janë:

Nr.	Emri i tenderuesit të Përgjegjshëm	Çmimi i ofruar	Radhitja sipas çmimit
4.	Clirimi&Favor Ing	8,886,401.59€ I korigjuar 8,916,285.44€	1
6.	Arbëria Com	10,235,587.10€	3
7.	Standard&Alb Architect	8,947,277.35€	2

Raporti i komisionit vlerësues:

Ne bazë te kriterit për dhënie te kontratës "Oferta e përgjegjshme me çmim me te lire", si fitues e rekomandojmë operatorin ekonomik "Çlirimi&Favor Ing" – Prizren, me çmimin e ofertës pas korrigjimit aritmetik: 8,886,401.59€.

Neni 54 i LPP-së – Njoftimi i kandidatëve - Tenderuesve

AK-ja, konform nenit 54 të LPP-së dhe nenit 37 të Udhëzuesit Operativ për Prokurimit Publik, i njofton operatorët ekonomik në lidhje me arsyet e eliminimit.

Neni 108/A - Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

Pas pranimit të letrës standarde OE-te ankues konform nenit 108/A, kanë parashtruar kërkesë për rishqyrtim, me ç'rast AK-ja, i refuzon ankesat si të pa bazuara.

Përgjigjet e ekspertit shqyrtues në lidhje me pretendimet ankimore të OE-ve ankues:

Sqarimi nr.1

Eksperti shqyrtues, sqaron se pas vendimit te Panelit shqyrtues, te date: 27.01.2017, AK-ja, e ka kthyer ne ri-vleresim kete aktivitet te prokurimit ku fillimisht i ka kërkuar te gjithe OE-ve pjesmarres ne kete aktivitet te prokurimit zgjatjen e validitetit te ofertave. Eksperti shqyrtues sqaron se nga njëzet (20) Operator ekonomik te cilet kane ofertuar, vetem Dhjet (10) kan pranuar qe ta zgjasim validitetin e ofertave.

Poashtu eksperti shqyrtues sqaron se pas vlerësimit te ofertave, nuk jane pajtuar te gjith anetaret komisionit. Anetari me numer rendor dy dhe tre nuk jane pajtuar dhe njëherit kane dhene deklaraten me shkrim lidhur me arsyet e mospajtimit dhe njëherit kane deklaruar se OE "Al Trade", i plotëson te gjitha kërkesat e dosjes se tenderit.

Sqarimi nr.2

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES "STANDARD & ALB ARCHITECT":

Eksperti shqyrtues, sqaron se OE ankues "Standard & Alb Architect", pas Ri-vleresimit te ofertave njoftohet nga AK-ja, si **tenderues i pasuksesshem** dhe njëherit sqaroj se OE ankues ne ankesen e tij i ka arsyetuar disa pika te eliminimit te cilat nuk kane te bejn fare me fazen e Ri-Vleresimit te këtij aktiviteti, por arsyet te cilat i ka cek ne ankes jane te fazes se pare te vlerësimit te ofertave (faze ne te cilen OE ankues "Standard" eshte eliminuar, si i papergjegjshem). Poashtu eksperti shqyrtues sqaron se OE ankues ka nje pretendim ankimor lidur me OE te rekomanduar per kontrat, i cili sipas OE ankues eshte shpallur i papergjegjshem me vendim te PSH-se nr. 442/16, 443/16 dhe 445/16. Lidhur me kete pretendim eksperti shqyrtues sqaron se ky pretendim eshte i pretendim te cilin e kane parashtruar te gjithe OE-te ankues ne ankesat e tyre dhe eksperti shqyrtues per kete pretendim do te jap nje sqarim ne fund te raportit te ekspertizes.

Sqarimi nr.3

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES "OLTI TRASING&BENI COM":

Eksperti shqyrtues, sqaron se OE ankues "Olti Trasing&Beni Com", eliminohet nga ky aktivitet i prokurimit me arsyetimin se:

- Lista e projekteve te përfunduara ne lëmin e ndërtimtarise, gjatë tri viteve të fundit marr se bashku (2013, 2014, 2015, pranohen edhe te 2016) në vlerë prej 5 milion euro. Kërkohet te kete te përfunduar nje ose me shume objekte shëndetësore me vlere investive ne ndërtim jo e te vogël se 500,000.00 €, (Lista kërkohet ne origjinal e nenshkruar dhe e vulosur). Nuk keni dëshmuar se keni ndertuar objekte shendetesore ne vler 500,000.00 euro sic eshte kërkuar ne dosje tenderit dhe te njoftimit per kontrat.

Eksperti shqyrtues, pasi ka analizuar oferten e OE ankues "Olti Trasing", sqaron se ne oferten origjinale ka ofruar nje kontrat te lidhur me 20 Nentor te vitit 2014 ne mes te Caritas - Luxembourg dhe konzorciumit "Euro Ing&Olti" – Ndertimi i ri i Qendres se Mjekesise Familjare me vler te kontrates 1,169,367.14 euro dhe gjithashtu kësaj kontrate i ka bashkangjitur edhe referencen, ndersa pranimin teknik nuk e ka dorezuar ne ofert. Eksperti shqyrtues, ne lidhje me kete sqaron se AK-ja, ne dosje te tenderit ka sqaruar se: Nuk pranohen projektet e papërfunduara-pa procesverbal te pranimit

teknik, te cilin OE ankues "Olti Trasing" nuk e ka dorezuar ne oferten e tij.
Ndersa sa i perket references se dorezuar ne ofert thuhet se konzorciumi ne fjal ka qene shume profesional dhe se i ka kompletuar te gjitha punet sipas kontrates. Andaj, sipas kerkeses se dosjes se tenderit OE ankues nuk e ka plotësuar ne teresi sic eshte kërkuar ne dosje te tenderit mirëpo ne baze te nenit 72 eshte dashur te verifikohet per faktin se kontrata eshte e nënshkruar ne vitin 2014, pra sipas kerkeses se dosjes se tenderit.

Lidhur me pretendimin e OE ankues "Olti Trasing", se OE "Standard&Alb Architect", ne oferten tij i mungon nje kontrat e përfunduar ne lemin e shendetesise ne vler prej: 500,000.00 euro dhe se i mungon nje deklarat qe dëshmon qe do ti përfundoj punimet ne afat kohor maksimum 600 dite pune ne rast se e fitojm kete kontrat. Eksperti shqyrtues sqaron se OE "Standard&Alb Architect", ne oferten e tij nuk ka ofruar deshmi sipas kerkeses se dosjes se tenderit. Ne oferten e tij ka ofruar kontrate ne ndertimin e objektit shendetesor mirëpo kjo kontrate eshte e nënshkruar ne vitin 2011, ndersa lidhur me kete kontrat i ka dorezuar kater raporte te pranimit teknik te perkohshem te cilat jane leshuar ne vitin 2013. Eksperti shqyrtues, sqaron se OE ankues nuk i ka ofruar deshmit sipas kerkeses se dosjes se tenderit per faktin se te gjitha raportet e pranimit teknik jane te perkohshem, pra nuk jane sipas kerkeses se AK-se, ku AK-ja ne dosje te tenderit, ka sqaruar per OE-te se: Nuk pranohen projektet e papërfunduara-pa procesverbal te pranimit teknik. Ndersa referenca per kete projekt i eshte leshuar me date: 30.12.2015.

Sa i perket pretendimit te OE ankues "Olti Trasing", ne lidhje me deklaraten e planin dinamik, eksperti shqyrtues, sqaron se OE "Standard" ne ankesen e tij e pranon qe nuk e ka ofruar mirëpo kete kerkese e arsyeton duke deklaruar se e kemi dorezuar planin dinamik te detajuar ne oferten e tij.
Mirëpo eksperti shqyrtues sqaron se ne dosje te tenderit dhe ne njoftimin per kontrat ne kerkesen nr. 4, AK-ja ka kërkuar:
Kërkesa 4: Operatori ekonomik duhet te deklaroj se është i përgatitur qe ta kryej ndërtimin e objektit ne teresi për një afat kohor maksimumi 600 dit pune.
Evidenca 4: Deklarate e operatorit ekonomik se është i përgatitur qe ta kryej ndërtimin e objektit ne tersi për një afat kohor maksimumi 600 dit pune.

Lidhur me pretendimin e OE ankues "Olti Trasing", se OE te rekomanduar per kontrat nuk e ka ofruar deklaraten ne lidhje me planin dinamik te parapare brenda 600 diteve, eksperti shqyrtues sqaron se ky pretendim i OE ankues eshte i paqendrueshem per faktin se ne oferten e te rekomanduarit per kontrat gjendet deklarata lidhur me planin dinamik te kërkuar nga AK-ja.

Ne lidhje me pretendimin e OE ankues "Olti Trasing", se OE i rekomanduar per kontrat eshte dashur te eliminohet nga ky aktivitet i prokurimit me arsyetimin se ka lende ne procedur konstestimore ne baze te certifikates se leshuar nga organi kompetent, eksperti shqyrtues, sqaron se ky pretendim eshte i paqendrueshem per faktin se sipas vërtetimit te leshauar nga gjykata OE i rekomanduar per kontrat nuk eshte i denuar sipas dispozitave te përcaktuara ne nenin 65 te LPP-se, por vetem ne procedur kontestimore.

Sa i perket pretendimit te OE ankues "Olti Trasing" se OE "Al Trade", nuk e ka se paku nje kontrat ne ndertimin e objekteve shendetesore ne vler prej: 500,000.00 euro, eksperti shqyrtues, sqaron se AK-ja, perkatesisht komisioni i Ri-vleresimit gjate kësaj faze ka kërkuar sqarime per kontratat dhe pranimet teknike te dorëzuara ne oferen e OE "Al Trade".
Eksperti shqyrtues sqaron se ne oferten e tij origjinale OE "Al Trade", i ka dorezuar tri kontrata ne ndertimin e objekteve shendetesore: Ndertimi i objektit te poliklinikes Kazermen e FSK-se ne

Prishtines, me nr. prokurimi: 21700/10/136/511 e nënshkruar me date: 20.01.2011. Kësaj kontrate i ka bashkangjitur eshte raportin e pranimit teknik. Eksperti shqyrtues, sqaron se pas sqarimeve te kërkuara lidhur me kontraten e lartpërmendur eshte vërtetuar se OE "Al Trade" ka përfunduar vetem 10% te kesaj kontrate.
Ne vazhdim eksperti shqyrtues, sqaron se OE "Al Trade", e ka ne oferten e tij kontraten me titull: Ndertimi i objektit te QKMF-se ne Skenderaj, me numer te prokurimit: 643/13/043/511e nënshkruar me date: 14.10.2013. Kësaj kontrate i ka bashkangjitur edhe raportin e pranimit teknik i cili eshte i pjesshem. Ndersa kontrata e tret e dorezuar ne ofert eshte me titull: Ndertimi i objektit te QKMF-se ne Prishtine, me numer te prokurimit: 616/13/182/511e nënshkruar me date: 19.11.2013 te ciles i ka bashkangjitur edhe raportin e pranimit përfundimtar te projektit mirëpo eksperti shqyrtues sqaron se vlera e kësaj kontrate eshte 487,986.93 euro. Prandaj, eksperti shqyrtues sqaron se ky pretendim i OE ankues eshte i qendrueshem.
Eksperti shqyrtues, duke u bazuar ne sqarimet e dhena vlereson se ankesa e OE ankues "Olti Trasing" eshte pjeserisht e bazuar.

Sqarimi nr.4

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES "PE-VLA-KU":
Eksperti shqyrtues, sqaron se OE ankues "Pe-Vla-ku", eliminohet nga ky aktivitet i prokurimit me arsyetimin se:

- Lista e ATK-se, për stafin e përhershëm (minimum 15 punëtor dhe 6 inxhinier) – origjinal ose kopje e noterizuar. Me këtë listë kërkohet te dëshmohet pagesa e kontributeve tatimore ne 3 mujorin e fundit para ofertimit (TM2). Te gjithë inxhinieret janë ofruar te Shqipërisë me kontribute te tatimeve mbi te ardhurat vetëm te Shqipërisë.

Sa i perket arsyes se pare te eliminimit, eksperti shqyrtues sqaron se kjo arsye e eliminimit eshte e njejt me ate te heres se pare, per te cilen eksperti shqyrtues ka dhene nje përgjigje dhe vlerësimi i ekspertit shqyrtues lidhur me kete ceshtje eshte i nejtjt me ate te dates: 22.12.2016.

- Inxhinieri Mekanik për transport dhe bujqësi Avni Sokoli, nuk është i profilit adekuat siç është kërkuar Inxhinier i Makinerisë dhe nuk ka referenca te punës profesionale siç është kërkuar minimum 5 vite, nuk kemi kërkuar Inxhinier Mekanik për transport dhe bujqësi gjë qe dëshmon edhe dokumentacioni përcjellës: Diploma Universitare, CV dhe Referenca.

Poashtu edhe arsyeja e dyte e elimimit eshte njejt me ate te heres se pare, prandaj, vlen i njëjti konstatim ne raporti ne dates: 22.12.2016

- Pas kerkeses per informata sqaruese OE ka vërtetuar profilin e diplomes se Inxh. Avni Sokoli qe eshte mekanik per transport dhe bujqësi.
- Inxh. Avni Sokoli nuk ka deshmi qe i njëjti ka kryer pune ne lemin perkatese qe eshte kërkuar ne dosje te tenderit.

Ceshtje tjeter eshte edhe qe inxh. Avni Sokoli nuk i perputhet mbiemri ne shumicen e dokumenteve te ofruara nga OE sic, eshte ne diplomen universitare, mbiemri Sokoli ndersa ne certifikaten e notave eshte Sokolaj, nje referenc nga Bashkia Kavaj eshte Sokoli ndersa ne dokumentin e administrates tatimore eshte Sokolaj. Kjo eshte perseritur edhe ne dokumente tjera ku ne si komision kemi vërejtje ne deklarim te rrejshem te dokumenteve sipas **LPP-se, neni 130.**

Sa i perket arsyetimit se pas sqarimeve rezulton se ne disa dokumente figuron mbiemri Sokolaj e ne disa Sokoli, eksperti shqyrtues sqaron se ne baze te provave te ofruara nga OE ankues rezulton te jet nje gabim teknik ne disa dokumente e inxhinierit te makinerise. Prandaj, lidhur me kete leshim teknik nuk mund te konsiderohet si i pa pergjegjshem OE ankues "Pevlaku".
Ndersa sa i perket pretendimeve ankimore ne lidhje me oferten e OE "Standr&Alb Architect", eksperti shqyrtues i ka sqaruar me lart.

Eksperti shqyrtues, duke u bazuar ne sqarimet e dhena vlereson se ankesa e OE ankues "Pevlaku" eshte pjeserisht e bazuar.

Sqarimi nr.5
PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES "ALKO-IMPEX":
Eksperti shqyrtues, sqaron se OE ankues "Alko-Impex", eliminohet nga ky aktivitet i prokurimit me arsyetimin se:

- Nuk e ka plotësuar sic duhet listen e cmimeve – pjesën II Paramasa dhe parallogaria konkretisht nuk ka ofruar çmim ne këto pozicione: 1.1 – poz.27; 1.2 – poz.9; 1.7 – poz.10; 2.2 – poz.12; 2.3 – poz.10; 2.4 – poz.4; 2.5 – poz.12; 2.6 – poz.15; 3.1 poz. I fundit.

Sipas UOPP-se, pika 39 ne tabelen e përshkruar te keasj pike si dhe nuk e ka te plotësuar Formularin e tenderit ku nuk e kan nënshkruar dhe vulosur te gjithe anetaret e konzorciumit.
Sipas UOPP-se, pika 39 ne tabelen e përshkruar te keasj pike.
Si komision, e kemi konsultuar edhe KRPP-ne, konkretisht tek pyetjet e shpeshta qe janë publikuar ne ueb faqe te KRPP-se, pyetja nr. 29, ku është specifikuar mjaft qartë, rasti kur operatori ekonomik nuk e plotëson një nga pozicionet ne listën e përshkrimit te çmimit, sipas këtij interpretimi, tenderi duhet te refuzohet. Ky interpretim vlen për te dy OE te lartcekur. Si dhe formularin e tenderit ku nuk e kan nënshkruar te gjithe anetaret e konzorciumit.

Eksperti shqyrtues, sqaron se OE ankues eshte eliminuar per aryet e njëjta te cilat jane sqaruar edhe ne raportin e pare te ekseprtizes, ku PSH-ja eshte njoftuar me dy interpretimet e KRPP-se, lidhur me pozicionet e paplotësuara ne paramas dhe parallogari. Prandaj, eksperti shqyrtues sqaron se kjo ceshtje duhet te diskutohet ne Panel per faktin se kemi dy interpretime te ndryshme te KRPP-se, per pozicionet e paplotësuara dhe se eksperti shqyrtues nuk mund te nxjerr nje përfundim te sakt te kësaj ceshtje.
Ndersa ne lidhje me mos nënshkrimin e formularit te tenderit nga anetaret e konzorciumit eksperti shqyrtues, sqaron se formulari i tenderit eshte i plotësuar. Sa i perket anetareve te konzorciumit te gjithe anetaret jane te paraqitur ne formularin e tenderit.
Eksperti shqyrtues, duke u bazuar ne sqarimet e dhena vlereson se ankesa e OE ankues "Alko-Impex" eshte pjeserisht e bazuar.

Sqarimi nr.6
PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES "ARBËRIA COM":
Eksperti shqyrtues, sqaron se OE ankues "Arbëria Com", njoftohet nga AK-ja, si tenderues i pasuksesshem dhe njëherit sqaroj se pretendimet ankimore te OE ankues te parashtruara ne ankes jane ndaj OE te rekomanduar per kontrat.

Lidhur me pretendimin e OE ankues se anetari i konzorciumit "Favor ing" eshte i papergjegjshem me arsyetimin se ne vërtetimin e ATK-se, figron se ka borxhe te pa shlyera, eksperti shqyrtues sqaron se

ne vërtetimin e dates: 28.06.2016 figuron se ka borxhe te pashlyera.

Sa i perket pretendimit se se OE i rekomanduar per kontrat nuk e ka deklaraten lidhur me planin dinamik, eksperti shqyrtues sqaron se kjo deklarat gjendet ne ofert, prandaj eshte i paqendrueshem ky pretendim.

Lidhur me pretendimin e OE ankues se deklaratat e anetareve te konzorciumit nuk jane te nënshkruara eksperti shqyrtues sqaron se ky pretendim eshte i paqendrueshem per faktin se te tri deklaratat jane te nënshkruara nga lideri dhe anetaret tjer te konzorciumit, ku eshte autorizuar edhe personi pergjegjes.

Sa i perket certifikates ISO 9001:2008, per te cilen ankuesi pretendon se certifikatat ISO nuk eshte per NPN "Clirimi" por eshte per "Clirimi" shpk, eksperti shqyrtues sqaron se certifikata ISO eshte e leshuar per NPN "Clirmi", ndersa nje certifikat tjeter qe gjendet ne ofert me Nr. ISO 39001:2012 eshte e leshuar per "Clirimi" shpk, prandaj ky pretendim eshte i paqendrueshem.

Eksperti shqyrtues, lidhur me pretendimin se referencat jane te leshuara nga dy persona te ndryshem juridik, eksperti shqyrtues, sqaron se referencat jane te nënshkruara mirëpo eksperti shqyrtues nuk ka deshmi dhe informat se kush eshte personi kompetent per nënshkrimin e dokumentacionit operatorit ekonomik.

Poashtu sa i perket pretendimit se projekt menaxheri i caktuar nga OE i rekomanduar per kontrat nuk e ka pervojen profesionale 8 vjeqare sipas kerkeses, eksperti shqyrtues, sqaron se nga deshmit e prezantura ne ofert projekt menaxheri ka ofruar deshmi per pevojen e tij mbi 10 vjeqare.

Sa i perket inxhinierit te energjetikes, se nuk ka pervojen e mjaftueshme, eksperti shqyrtues sqaron se poashtu edhe ky pretendim i OE ankues eshte i paqendrueshem sepse përvoja e këtij inxhinieri nuk eshte vetem ne KEK sic pretendon OE ankues por edhe ne institucione tjera dhe te OE "Clirimi".

Poashtu sa i perket planit dinamik te detajuar, eksperti shqyrtues sqaron se ne oferten e tij OE i rekomanduar per kontrat e ka dorezuar planin dinamik sipas kerkeses.

Sa i perket pretendimit te OE ankues qe ka te beje me oferten e OE "Standard&Alb Architect", lidhur me deklaraetn e planit dinamik eksperti shqyrtues e ka sqaruar me lart.

Lidhur me pretendimin se OE "Standard&Alb Architect", ka borxhe te pashlyera ne Administraten Tatimore te Kosoves, eksperti shqyrtues sqaron se ne vërtetimin e dorezuar ne oferten e tij figuron qe ky OE ka borxhe te pashlyera, mirëpo eksperti shqyrtues sqaron se ky dokument sipas dispozitave te LPP-se, mund te kërkohet para dhënies se kontrates mirëpo ne rastin konkret OE "Standard&Alb Architect", nuk eshte rekomanduar per kontrat.

Sa i perket vërtetimit tatimore dhe qarkullimit bankar per tri vitet e fundit OE "Standard&Alb Architect", ne oferten e tij ka ofruar mjftueshem deshmi se e mbulon kete kerkese, ndersa sa i perket vetretimit ne te njëjtin vërtetim figurojn edhe vitet 2013, 2014 dhe 2015.

Eksperti shqyrtues, duke u bazuar ne sqarimet e dhena vlereson se ankesa e OE ankues "Arberia Com" eshte pjeserisht e bazuar.

Sqarimi nr.5

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES "AL-TRADE":

Eksperti shqyrtues, sqaron se OE ankues "Al-Trade", eliminohet nga ky aktivitet i prokurimit me arsyetimin se:

- OE nuk e ka deshmin qe ka kryer pune te pranuara ne vler prej 500,000.00 euro ne objekte shendetesore. Dokumentet e prezantuara vertetojn qe ne Skenderaj e ka pranimin e pjesshem qe nënkupton se punet nuk jane kryer teresisht si dhe kerkesen per pranim te puneve vet OE e ka bere per pranim te pjesshem. Referenca per ndertimin e spitalit te FSK-se, ne Prishtine, pas kerkeses per informate sqaruese kemi marr konfirmimin qe OE "Al Trade", ka kryer 10% te vleres se kontrates por vetem furnizim e jo pune sic eshte kërkuar ne dosje te tenderit. Ka te dokumentuar nje QKMF ne komunen e Prishtines ne vler prej 487.986.93 euro.

Sa i perket arsyes se eliminimit te OE ankues OE "Al Trade", se nuk e ka se paku nje kontrat ne ndertimin e objekteve shendetesore ne vler prej: 500,000.00 euro, eksperti shqyrtues, sqaron se AK-ja, perkatesisht komisioni i Ri-vleresimit gjate kësaj faze ka kërkuar sqarime per kontratat dhe pranimet teknike te dorëzuara ne oferen e OE "Al Trade".

Eksperti shqyrtues sqaron se ne oferten e tij origjinale OE "Al Trade", i ka dorezuar tri kontrata ne ndertimin e objekteve shendetesore: Ndertimi i objektit te poliklinikes Kazermen e FSK-se ne Prishtines, me nr. prokurimi: 21700/10/136/511 e nënshkruar me date: 20.01.2011. Kësaj kontrate i ka bashkangjitur eshte raportin e pranimit teknik. Eksperti shqyrtues, sqaron se pas sqarimeve te kërkuara lidhur me kontraten e lartpërmendur eshte vërtetuar se OE "Al Trade" ka përfunduar vetem 10% te kesaj kontrate.

Ne vazhdim eksperti shqyrtues, sqaron se OE "Al Trade", e ka ne oferten e tij kontraten me titull: Ndertimi i objektit te QKMF-se ne Skenderaj, me numer te prokurimit: 643/13/043/511e nënshkruar me date: 14.10.2013. Kësaj kontrate i ka bashkangjitur edhe raportin e pranimit teknik i cili eshte i pjesshem.

Ndersa kontrata e tret e dorezuar ne ofert eshte me titull: Ndertimi i objektit te QKMF-se ne Prishtine, me numer te prokurimit: 616/13/182/511e nënshkruar me date: 19.11.2013 te ciles i ka bashkangjitur edhe raportin e pranimit përfundimtar te projektit mirëpo eksperti shqyrtues sqaron se vlera e kësaj kontrate eshte 487,986.93 euro.

Andaj, duke u bazuar ne kerkesen e dosjes se tenderit, eksperti shqyrtues sqaron se OE ankues "AL Trade" nuk e ka plotësuar kete kerkeses te dosjes se tenderit – versionin e fundit te dates: 17.08.2016, per faktin se eshte kërkuar te ketë te përfunduar se paku një objekt shëndetësor me vlere investive ne ndërtim jo e te vogël se 500,000.00 €.

Poashtu eksperti shqyrtues, sqaron se lidhur me kontraten ne ndertimin e objektit shendetesor, AK-ja, gjate fazes se Ri-vleresimit ka kërkuar sqarim lidhur me keto kontrata, ku OE ankues "Al Trade", ka deklaruar se kontrata me vlere 487,986.93 eshte 100% e përfunduar ndersa kontrata ne vlere prej: 3,889,961.39 euro vetem 10 % e realizuar.

Lidhur me pretendimin e OE ankues "Al Trade", se menaxheri i projektit i OE te rekomanduar per kontrat nuk ka referenca te leshuara nga autoritet kontraktuese, eksperti shqyrtues sqaron se nuk ka qene kerkese qe referencat te leshohen apo te jen nga ndonje autoritet kontraktues. Gjithashtu ne CV-in dhe referencene leshuar nga punedhenesi figuron se menaxheri i projektit e ka pervojen sipas kerkeses. Prandaj, ky pretendim eshte i paqenrueshem.

Lidhur me pretendimin e OE ankues se vetem lideri i grupit e ka dorezuar certifikaten ISO 9001:2008, eksperti shqyrtues sqaron se kjo kerkese eshte vendosur sipas dispozitave te nenit 66 te LPP-se, andaj, ne baze te nenit 71 te LPP-se, cdo kërkesë e vendosur nga një autoritet kontraktues sipas neneve 66.2, 68 dhe 69 të këtij ligji do të aplikohet vetëm ndaj grupit si tërësi dhe jo ndaj anëtarëve individual të grupit. Poashtu ne lidhje me validitetin kjo kësaj certifikate eksperti shqyrtues sqaron se kjo ceshtje eshte sqaruar edhe ne raportin e pare te ekspertizes, sa i perket validitetit ne certifikate she shenuar data e skadimit 04.01.2019.
Ne lidhje me pretendimin se kontrata: Ndertimi i objektit te ri te universitetit publik te Prizrenit dhe kontrata ndertimi i qendres se paraburgimit ne Gjilan nuk kan referenca ekspertishqyrtues sqaron se keto kontrata te dorëzuara ne oferten origjinale kane raporte te pranimit teknik, prandaj ky pretendim eshte i paqendrueshem.

Ne lidhje me pretendimin e OE ankues per stafin profesional te OE te rekomanduar per kontrat eksperti shqyrtues sqaron se sipas kerkeses se dosjes se tenderit ku eshte kërkuar stafi i perhershem prej 5 inxhineireve, eksperti shqyrtues sqaron se ne oferten et ij OE i rekomanduar per kontrat, kater inxhinier i ka ofruar sipas kerkeses, ndersa ne lidhje me inxhinierin e elektros i ka ofruar dy inxhinier: Kujtim Suka te cilit ne kontrat i figurojn vetem 40 ore pune dhe ne listen e ATK-se eshte deklaruar si i angazhuar me pune sekondare ne kompanin "Clirimi", ndersa inxhinieri tjeter i elektros Xhelal Kukaj, figuron ne listen e ATK-se si sekondar, ndersa ne CV-in e tij thuhet se punon prej vitit 2013-2016. Andaj, duke u bazuar ne keto te dhena eksperti shqyrtues sqaron se lidhur me inxhinierin e elektros Xhelal Kukaj ka te dhena kontradiktore, pra nuk dihet sakt a asht punëtor i perhershem i kompanise "Clirmi". Prandaj, keto te dhena duhet te verifikohen sipas nenit 72 te LPP-se.
Poashtu sa i perket pretendimit te OE ankues se certifikata ISO 9001:2008 e OE telekomanduar per kontrat nuk eshte valide, me arsyetimin se kjo certifikat nuk gjendet ne ueb faqen zyrtare te certifikuesit, eksperti shqyrtues sqaron se edhe ne ekspertizen e pare eshte sqaruar lidhur me kete certifkat ku eksperti shqyrtues ka kërkuar nga AK-ja, qe gjate fazes se Ri-vleresimit te behet verifikimi i saj pran certifikuesit. Andaj, ky pretendimi eshte i qendrueshem.

Eksperti shqyrtues, duke u bazuar ne sqarimet e dhena vlereson se ankesa e OE ankues "Al-Trade" eshte pjeserisht e bazuar.

Ne fund te sqarimeve te dhena eksperti shqyrtues, sqaron se pas vendimit te PSH-se, me nr. 442/16, 443/16 dhe 445/16, Autoriteti kontraktues e kthyer ne Ri-vleresim kete aktivitet te prokurimit ku gjate rivleresimit e ka verifikuar edhe nje here kontraten e OE "Clirimi". Ne sqarimin e dhene Emirates Link Maltauro LLC, ka deklaruar se OE "Favor ing" me sukses i ka përfunduar punimet me daten: 31 May 2016.
Megjithatë eksperti shqyrtues, sqaron se gjate shqyrtimit te pretendimeve ankimore te OE-ve ankues, te cilet kane pasur pretendime ankimore ne lidhje me oferten e te rekomanduarit per kontrat, ka gjetur se vlerësimi, ekzaminimi dhe krahasimi nuk eshte bere konform nenit 59 te LPP-se, per faktin se sic eshte cekur edhe me lart lidhur me inxhinierin e elektros ka deshmi kontradiktore te cilat nuk jane verifikuar nga AK-ja, poashtu edhe ne lidhje me certifkkaten ISO 9001:2008 eshte e nevojshme te verifikohet dhe ne fund lidhur me oferten e te rekomanduarit per kotnrat eksperti shqyrtues sic ka sqaruar edhe me lart anetari i konzorciumit OE "Favor Ing", ka borxhe te pashlyera ne Administraten Tatimore te Kosoves, vërtetim te cilin AK-ja eshte dashur te ja kërkoj para dhënies se kontrates. Eksperti shqyrtues sqaron se sipas dispozitave te nenit 71.4 te LPP-se, Nëse një tender dorëzohet nga një grup i operatorëve ekonomik, secili anëtar i grupit është i obliguar të dëshmojë ose konfirmojë në përputhje me nenin 67 të këtij ligji, se nuk është i përjashtuar nga pjesëmarrja në aktivitetin e prokurimit sipas nenit 65 të këtij ligji.

Prandaj, edhe njeher eksperti shqyrtues, sqaron se pretendimet ankimore te OE-ve ankues per shkelje te dispozitave te LPP-se, te parashtruara ne ankes jane pjesërisht te qëndrueshme. Andaj, eksperti shqyrtues propozon qe ky aktivitet i prokurimit te kthehet ne Ri-vleresim dhe te zbatohen ne teresi dispozitat e shkelura nga ana e AK-se.

Mendimi i ekspertit shqyrtues :

- Eksperti shqyrtues bazuar në konstatimet e cekura në ekspertizë mendon që Autoriteti Kontraktues – **Ministria e Shëndetësisë (MSH),** për aktivitetin e prokurimit **"Ndërtimi i spitalit regjional në Ferizaj",** me nr. të Prokurimit: 206/16/044/511, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – **Ministria e Shëndetësisë (MSH).**
- Prandaj eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ta anulojë vendimin e AK-së për dhënie të kontratës dhe propozon që ky aktivitet i prokurimit të **Rivlerësohet,** ndersa ankesat e OE-ve, ankues te aprovohen si pjeserisht te bazuara.